LIGJ

Nr. 92/2014

PËR TATIMIN MBI VLERËN E SHTUAR NË

REPUBLIKËN E SHQIPËRISË[1]

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 155, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I

OBJEKTI DHE FUSHA E ZBATIMIT

Neni 1

Objekti i ligjit

1. Ky ligj vendos tatimin mbi vlerën e shtuar (TVSH-në).
2. TVSH-ja është një tatim i përgjithshëm mbi konsumin e mallrave dhe shërbimeve, proporcional me çmimin e tyre, që i ngarkohet në çdo fazë të prodhimit dhe procesit të shpërndarjes çmimit pa tatimin.

   TVSH-ja zbatohet si një tatim në përqindje mbi çmimin e mallrave dhe shërbimeve dhe bëhet e kërkueshme për t'u paguar pas zbritjes së TVSH-së që rëndon drejtpërdrejt elementet e kostos së mallrave dhe të shërbimeve.

---

[1] *Ky ligj është përafruar pjesërisht me*: *Direktivën e Parlamentit Europian dhe Këshillit 2006/112/KE, datë 28 nëntor 2006, "Mbi Sistemin e Përbashkët të Tatimit mbi Vlerën e Shtuar", Numri CELEX 32006L0112, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, Seria L, Nr.* 347*, datë,* 11.12.2006, faqe 1–118, e ndryshuar".

Neni 2
Fusha e zbatimit

Tatimit mbi vlerën e shtuar i nënshtrohen:

a) të gjitha furnizimet e mallrave dhe shërbimeve, të kryera kundrejt pagesës, brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, nga një person i tatueshëm që vepron si i tillë;
b) të gjitha importet e mallrave në territorin e Republikës së Shqipërisë.

KREU II

PERSONAT E TATUESHËM

Neni 3
Personat e tatueshëm

Person i tatueshëm konsiderohet çdo person, pavarësisht nga forma e organizimit të tij, i cili në mënyrë të pavarur kryen veprimtari ekonomike, cilido qoftë vendi dhe qëllimi ose rezultati i kësaj veprimtarie.

Në kuptim të këtij neni, nuk konsiderohet person i tatueshëm çdo organizatë jofitimprurëse për pagesa të përfituara nga kuotizacionet, nëse kanë të tilla, ose fonde, grante, donacione të përfituara për qëllime të veprimtarisë jofitimprurëse të organizatës, në përputhje me ligjin për organizatat jofitimprurëse, përveç kur kjo organizatë përfiton pagesa si rezultat i veprimtarisë ekonomike.

Neni 4
Veprimtaria ekonomike

Veprimtari ekonomike është çdo veprimtari e kryer nga prodhuesit, tregtarët, personat që furnizojnë mallra ose shërbime, përfshirë veprimtarinë nxjerrëse, bujqësore dhe aktivitetet profesionale.

Veprimtari ekonomike konsiderohet gjithashtu shfrytëzimi i pasurisë së trupëzuar ose të patrupëzuar, me qëllim realizimin e të ardhurave me karakter të vazhdueshëm.

Neni 5
Ushtrimi i një veprimtarie ekonomike në mënyrë të pavarur

Në kuptim të nenit 3, të këtij ligji, shprehja "në mënyrë të pavarur" nënkupton personat të cilët nuk janë të punësuar ose të lidhur me një punëdhënës me anë të një kontrate punësimi apo

ndonjë lidhjeje tjetër ligjore që krijon marrëdhënie punëdhënës - punëmarrës dhe ka të bëjë me kushtet e punës, shpërblimin e punëmarrësit dhe përgjegjësitë e punëdhënësit.

Aktiviteti i ushtruar nga punëmarrësi, i përcaktuar në Kodin e Punës, si puna në shtëpi, të ardhurat e të cilit konsiderohen si pagë apo shpërblim, nuk nënkupton kryerjen e një veprimtarie ekonomike në mënyrë të pavarur.

Neni 6
Organet publike

1. Organet e pushtetit qendror dhe vendor dhe organe të tjera të së drejtës publike nuk konsiderohen si persona të tatueshëm për veprimtari ose për veprime që ushtrojnë për qëllim dhe në ushtrimin e funksionit të tyre si autoritete publike edhe atëherë kur përfitojnë taksa, tarifa, kontribute dhe pagesa.

2. Nëse këto organe kryejnë veprimtari apo veprime të tilla si ato të përcaktuara në pikën 1, të këtij neni, dhe të qenit person jo i tatueshëm shkakton shtrembërim të konkurrencës, atëherë konsiderohen persona të tatueshëm për këto veprimtari apo veprime.

3. Në çdo rast organet e përcaktuara në pikën 1, të këtij neni, konsiderohen si persona të tatueshëm nëse kryejnë veprimtaritë e renditura në aneksin 1 bashkëlidhur këtij ligji kur këto veprimtari nuk janë të papërfillshme.

KREU III
TRANSAKSIONET E TATUESHME

SEKSIONI 1
FURNIZIMI I MALLRAVE

Neni 7
Furnizimi i mallit

1. Me furnizim mallrash kuptohet transferimi i së drejtës për të disponuar si pronar pasurinë e trupëzuar.
2. Konsiderohen gjithashtu si “Furnizim malli” edhe transaksionet e mëposhtme:
    a) transferimi kundrejt pagesës i pronësisë së pasurisë, me urdhër nga/apo në emër të një autoriteti publik apo në zbatim të ligjit;
    b) dorëzimi i mallrave në bazë të një kontrate, ku parashikohet dhënia me qira e mallit për një periudhë të caktuar ose shitja me këste e mallit, kalimi i pronësisë i të cilit bëhet me pagesën e kështit të fundit;
    c) transferimi i mallrave bazuar në një kontratë, sipas së cilës paguhet komision për blerjen apo për shitjen.

3. Furnizimi i energjisë elektrike, ujit, gazit, energjisë për ngrohje ose ftohje dhe të tjera të ngjashme trajtohet si furnizim malli i trupëzuar.

Neni 8
Mallra të tjera

Pasuri e trupëzuar, në kuptim të këtij ligji, konsiderohen gjithashtu:

a) të drejtat mbi pasurinë e paluajtshme, të cilat i japin mbajtësit të drejtën për ta shfrytëzuar atë, me përjashtim të qiradhënies që rezulton nga kontrata qiraje;

b) të drejtat reale, të cilat i japin mbajtësit të tyre të drejtën e përdorimit mbi pasurinë e paluajtshme;

c) aksione apo të drejta ekuivalente me aksionet, që i japin mbajtësit juridikisht ose faktikisht të drejtën e pronësisë ose të drejtën e posedimit mbi pasurinë e paluajtshme apo mbi një pjesë të saj.

Neni 9
Furnizimi i mallrave kundrejt pagesës

1. Furnizimi i mallit konsiderohet i kryer kundrejt pagesës, tërësisht ose pjesërisht, nëse furnizuesi direkt apo indirekt merr apo ka të drejtë të marrë pagesë në para a në natyrë për atë furnizim, si prej personit të furnizuar apo ndonjë personi tjetër.

2. Trajtohen gjithashtu si furnizime malli kundrejt pagesës rastet kur:

a) një person i tatueshëm merr mallra që janë pjesë e pasurisë së biznesit, për qëllim privat të tij apo të stafit të tij, apo për qëllime të ndryshme nga ato të veprimtarisë së tij ekonomike, në qoftë se ka zbritur tërësisht apo pjesërisht TVSH-në në blerje të këtij malli apo elementeve që përbëjnë mallin;

b) në rastet e çregjistrimit, të gjitha mallrat e furnizuara për personin e tatueshëm dhe ende në pronësi të personit të tatueshëm, si pjesë e pasurisë së biznesit, në qoftë se është zbritur tërësisht apo pjesërisht TVSH-ja në blerje e mallit apo elementeve që përbëjnë mallin;

c) një person i tatueshëm përdor për nevojat e biznesit të tij një mall të prodhuar, të nxjerrë, të përpunuar, të blerë, të importuar, në kuadrin e aktivitetit të tij dhe kur blerja e këtij malli te një person tjetër i tatueshëm, kryer në momentin e përdorimit të tij për nevojat e biznesit, nuk do të kishte të drejtë të plotë zbritjeje të TVSH-së, sepse e drejta e zbritjes mbi këtë mall përbën objekt përjashtimi, kufizimi apo mund të jetë objekt rregullimi. Kjo dispozitë zbatohet edhe në rastet kur mallrat përdoren për transaksione jashtë fushës së zbatimit të TVSH-së;

ç) një person i tatueshëm përdor një mall në një sektor aktiviteti të përjashtuar, pa të drejtë zbritjeje, në rastin kur ky mall ka pasur të drejtë të plotë ose të pjesshme të zbritjes së TVSH-së në momentin e blerjes apo përdorimit të tij për nevoja të biznesit së vet.

3. Nuk trajtohet si furnizim malli kundrejt pagesës përdorimi i mallrave të biznesit si mostra (kampione) ose dhuratat me vlerë të vogël.

4. Ministri i Financave përcakton me udhëzim, në kuptim të këtij neni, se çfarë konsiderohet "mostër" dhe vlerën maksimale të "dhuratave me vlerë të vogël".

SEKSIONI 2
FURNIZIMI I SHËRBIMIT

Neni 10
Përkufizim i furnizimit të shërbimit

1. Me furnizim shërbimesh kuptohet çdo transaksion që nuk është furnizim mallrash, përveç rasteve që në këtë ligj përcaktohet ndryshe.

2. Furnizimi i shërbimeve, të bëra prej një të punësuari për punëdhënësin e tij për arsye të punësimit, nuk është furnizim shërbimi nga i punësuari.

3. Me "Shërbime telekomunikacioni" kuptohet furnizimi i shërbimeve që lidhen me transmetimin, emetimin apo recepsionin (kapjen, marrjen) e sinjaleve, fjalëve, imazheve dhe tingujve apo informacioneve të çdo natyre me anë të aparateve "wire", radios, sistemeve optike apo sistemeve të tjera elektromagnetike, përfshirë edhe transferimin e së drejtës përkatëse për të përdorur kapacitetet për realizimin e të tilla transmetimeve, emisioneve apo recepsioneve, që mundësojnë hyrjen (aksesin) në rrjetet globale të informacionit.

Neni 11
Furnizime shërbimi

Konsiderohen gjithashtu si furnizime shërbimi:

a) kalimi i një pasurie të patrupëzuar (jomateriale), pavarësisht nëse përfaqësohet ose jo me titull pronësie;

b) transaksionet mbi aksionet, pjesëmarrjet në shoqëri, obligacionet dhe titujt e tjerë, të ndryshëm nga ata të përcaktuar në nenin 8, të këtij ligji;

c) operacionet e ndërtimit, kryerja e procesit të ndërtimit, si dhe të mirëmbajtjes;

ç) detyrimi për të mos kryer një veprim apo për të lejuar/toleruar një veprim apo një situatë;

d) kryerja e shërbimeve në zbatim të një urdhri të dhënë nga/ose në emër të një autoriteti publik apo në zbatim të ligjit.

Neni 12
Furnizimi i shërbimit kundrejt pagesës

1. Furnizimi i shërbimit konsiderohet i kryer kundrejt pagesës, tërësisht ose pjesërisht, nëse furnizuesi direkt a indirekt merr apo ka të drejtë të marrë pagesë në para a në natyrë për atë furnizim, si prej personit të furnizuar apo ndonjë personi tjetër.

2. Konsiderohet si furnizim shërbimi kundrejt pagesës secili prej transaksioneve të mëposhtme:

a) përdorimi për qëllime private i mallrave që bëjnë pjesë në pasurinë e sipërmarrjes nga personi i tatueshëm apo stafi i tij apo përgjithësisht për qëllime të ndryshme nga ato të veprimtarisë së tij ekonomike, në qoftë se ka zbritur tërësisht apo pjesërisht TVSH-në në blerje për këto mallra;

b) furnizimi i shërbimeve të kryera pa pagesë nga një person i tatueshëm për nevojat e tij personale apo të stafit të tij apo përgjithësisht për qëllime të ndryshme nga ato të veprimtarisë së tij ekonomike;

c) furnizimi i shërbimeve nga një person i tatueshëm, për qëllime të veprimtarisë së tij ekonomike, në rastin kur TVSH-ja për furnizimin e këtij shërbimi, po të ishte kryer prej një personi tjetër të tatueshëm, nuk do të ishte tërësisht e zbritshme.

3. Ministri i Financave ka të drejtë të përcaktojë me udhëzim rastet kur nuk veprohet sipas pikave 1 dhe 2, të këtij neni, me kusht që të mos sjellin si pasojë shtrembërimin e konkurrencës.

Neni 13
Furnizimi i shërbimeve në emër të tij, por për llogari të një personi tjetër

Kur një person i tatueshëm, i cili vepron në emrin e tij, por për llogari të një personi tjetër, merr pjesë në kryerjen e një furnizimi shërbimi, ai konsiderohet sikur ka marrë dhe ka furnizuar vetë këtë shërbim.

SEKSIONI 3
IMPORTIMI I MALLRAVE

Neni 14
Importimi i mallrave

Për qëllimet e këtij ligji me termin "importimi i mallrave" kuptohet çlirimi për qarkullim të lirë i mallrave në territorin e Republikës së Shqipërisë, siç përcaktohet në legjislacionin doganor në fuqi.

SEKSIONI 4
DISPOZITA TË TJERA PËR TRANSAKSIONET E TATUESHME

Neni 15
Vetëfurnizimi i mallrave dhe shërbimeve

1. Për qëllime të këtij ligji, konsiderohet si furnizim kundrejt pagesës nga personi i tatueshëm furnizimi i mallrave të prodhuara, të ndërtuara, të nxjerra, të përpunuara, të blera ose furnizimi i shërbimeve në kuadër të veprimtarisë së tij ekonomike për t'u përdorur për nevoja të kësaj veprimtarie.

2. Në kuptim të pikës 1, të këtij neni, personi i tatueshëm furnizon dhe gjithashtu i trajton këto mallra ose shërbime si furnizime të marra prej tij, për qëllime të veprimtarisë ekonomike, duke aplikuar zbritshmërinë e TVSH-së, në përputhje me dispozitat e këtij ligji.

Neni 16

Transferimi i veprimtarisë ekonomike

1. Transferimi i veprimtarisë, në kuptim të këtij ligji, konsiderohet transferimi kundrejt pagesës ose jo apo në formën e një kontributi në një sipërmarrje i tërësisë së aseteve apo të një pjese të tyre.

2. Transferimi i veprimtarisë ekonomike nuk përbën furnizim malli ose shërbimi, në kuptim të këtij ligji, por përbën një kalim të aseteve nga personi i tatueshëm transferues te një person, i cili trajtohet si pasardhësi i transferuesit, me kusht që ky person të jetë ose të bëhet person i tatueshëm, në bazë të këtij ligji, për veprimtarinë ekonomike ose pjesën e saj që transferohet, duke siguruar vazhdimësinë ekonomike të veprimtarisë, në kushte të ngjashme si përpara transferimit.

3. Çdo detyrim dhe e drejtë e transferuesit, e njohur nga/ose me anë të këtij ligji para kohës së transferimit, bëhet detyrim dhe e drejtë e marrësit të transferimit.

4. Të gjitha të dhënat, librat dhe regjistrimet që kanë të bëjnë me tërësinë e aseteve apo pjesën e tyre që është transferuar dhe që kanë qenë të detyrueshme për t'u mbajtur, bazuar në ligjin për tatimin mbi vlerën e shtuar ose me këtë ligj, tashmë në vend të transferuesit duhet të mbahen nga marrësi i transferimit.

5. Personat e tatueshëm, palë në procesin e transferimit të veprimtarisë ekonomike, duhet të njoftojnë për qëllimin e tyre, për zbatimin e këtij neni, Drejtorinë Rajonale Tatimore përkatëse, të paktën 45 ditë kalendarike përpara se të ndodhë transferimi.

6. Personi i tatueshëm, marrës i transferimit, nëse është e nevojshme, është i detyruar të bëjë rregullimin e TVSH- së së zbritur nga transferuesi në përputhje me afatin për të drejtën e zbritjes dhe veprimtarinë ekonomike, për të cilën do të përdoren asetet e transferuara te marrësi, sipas nenit 80, të këtij ligji.

7. Ministri i Financave ka të drejtë të përcaktojë me udhëzim procedurat dhe rregullat e veçanta për transferimin e veprimtarisë ekonomike, me qëllim shmangien dhe parandalimin e evazionit fiskal.

Neni 17

Furnizimet e përziera

1. Furnizimi i shërbimeve, i përfshirë në furnizimin e mallrave, është pjesë e furnizimit të mallrave.

2. Furnizimi i mallrave, i përfshirë në furnizimin e shërbimeve, është pjesë e furnizimit të shërbimeve.

3. Furnizimi i shërbimeve, i përfshirë në importin e mallrave, është pjesë e importit të mallrave.

KREU IV
VENDI I FURNIZIMIT TË TRANSAKSIONEVE TË TATUESHME

SEKSIONI 1
VENDI I FURNIZIMIT TË MALLRAVE

Neni 18
Furnizimi i mallrave pa transport

Kur mallrat nuk dërgohen ose nuk transportohen, vendi i furnizimit të mallrave është në Republikën e Shqipërisë nëse mallrat ndodhen në Republikën e Shqipërisë në momentin kur kryhet furnizimi.

Neni 19
Furnizimi i mallrave me transport

1. Kur mallrat janë dërguar apo transportuar nga furnizuesi, nga blerësi apo një palë e tretë, vendi i furnizimit është në Republikën e Shqipërisë, nëse mallrat ndodhen në Republikën e Shqipërisë, në momentin kur fillon dërgimi apo transporti i tyre për blerësin.

2. Kur mallrat e dërguara apo të transportuara nga furnizuesi, nga blerësi apo një palë e tretë instalohen apo montohen, me/ose pa testim, nga/ose për llogari të furnizuesit, vendi i furnizimit është në Republikën e Shqipërisë nëse mallrat janë instaluar apo montuar në Republikën e Shqipërisë.

Neni 20
Furnizimi i mallrave në bordin e anijeve, aeroplanëve ose trenave

Kur mallrat janë furnizuar në bordin e anijeve, avionëve ose trenave, vendi i furnizimit të mallrave është në Republikën e Shqipërisë nëse pika e nisjes së transportit të pasagjereve është në Republikën e Shqipërisë.

Në rastin e udhëtimit vajtje-ardhje, pjesa e kthimit konsiderohet si veprim i veçantë transporti.

Neni 21
Furnizimi i gazit natyror, energjisë elektrike dhe ujit nëpërmjet sistemeve të shpërndarjes

1. Në rastin e furnizimit të gazit natyror, energjisë elektrike, energjisë për ngrohje ose ftohje dhe ujit nëpërmjet sistemeve të shpërndarjes, për një person të tatueshëm rishitës, vendi i

furnizimit konsiderohet të jetë në Republikën e Shqipërisë, ku rishitësi ka vendosur selinë e veprimtarisë së tij ekonomike ose ku ka një vendndodhje të qëndrueshme nga furnizohen mallrat ose, në mungesë të këtyre, vendi ku ai ka adresën e tij të përhershme ose ku zakonisht banon.

Për qëllim të këtij paragrafi, termi "person i tatueshëm rishitës" nënkupton personin e tatueshëm, qëllimi kryesor i veprimtarisë ekonomike të të cilit në lidhje me blerjet e gazit, energjisë elektrike, energjisë për ngrohje ose ftohje dhe ujit është rishitja e këtyre produkteve, ndërkohë që konsumimi nga ai vetë i këtyre produkteve është i papërfillshëm.

2. Në rastin e furnizimit të gazit natyror, energjisë elektrike, energjisë për ngrohje ose ftohje dhe ujit nëpërmjet sistemeve të shpërndarjes për një person të ndryshëm nga ai i parashikuar në pikën 1, të këtij neni, vendi i furnizimit është në Republikën e Shqipërisë, në vendin ku konsumatori efektivisht shfrytëzon dhe konsumon këto mallra.

Kur e gjitha apo një pjesë e gazit, energjisë elektrike, energjisë për ngrohje ose ftohje dhe ujit të furnizuar, efektivisht nuk është konsumuar nga blerësi konsumator, ky mall i pakonsumuar konsiderohet sikur të jetë shfrytëzuar në Republikën e Shqipërisë, në vendin ku blerësi konsumator ka vendosur selinë e veprimtarisë së tij ekonomike ose ku ka një vendndodhje të qëndrueshme, për të cilin janë furnizuar këto mallra. Në mungesë të këtyre të fundit, konsiderohet se mallrat janë shfrytëzuar apo konsumuar në Republikën e Shqipërisë, në vendin ku ka adresën e tij të përhershme ose ku zakonisht banon.

SEKSIONI 2
VENDI I IMPORTIMIT TË MALLRAVE

Neni 22
Vendi i importimit të mallrave

1. Vendi i importimit të mallrave është në Republikën e Shqipërisë nëse mallrat me origjinë nga territore të tjera çlirohen për qarkullim të lirë në territorin doganor shqiptar.

2. Në përjashtim nga pika 1, e këtij neni, mallrat, të cilat në momentin e hyrjes në Republikën e Shqipërisë nuk janë në qarkullim të lirë, por i nënshtrohen ndonjërit prej regjimeve të parashikuara në nenet 64 dhe 65, të këtij ligji, ose nën regjime të përkohshme importimi, me përjashtim total nga taksat doganore, ose regjimit të transitit, vendi i importimit të këtyre mallrave është në Republikën e Shqipërisë nëse këto mallra çlirohen nga regjimet ose situatat e sipërpërmendura në territorin doganor shqiptar.

SEKSIONI 3
VENDI I FURNIZIMIT TË SHËRBIMEVE

Neni 23
Përkufizime

Me qëllim zbatimin e rregullave që lidhen me vendin e furnizimit të shërbimeve:

a) personi i tatueshëm, i cili kryen, gjithashtu, transaksione, të cilat nuk janë furnizime të tatueshme mallrash ose shërbimesh, në kuptim të nenit 2, të këtij ligji, konsiderohet person i tatueshëm për të gjitha furnizimet e shërbimeve që i janë furnizuar këtij personi për nevojat e veprimtarisë;

b) një person juridik i patatueshëm, sipas kuptimit të këtij ligji, i pajisur me një numër identifikimi të TVSH-së, konsiderohet person i tatueshëm.

Neni 24
Rregulli i përgjithshëm

1. Vendi i furnizimit të shërbimit është në Republikën e Shqipërisë nëse marrësi i shërbimit, një person i tatueshëm që sillet si i tillë, ka në Republikën e Shqipërisë:

a) selinë e veprimtarisë të tij ekonomike ose një vendndodhje të qëndrueshme për të cilën janë kryer shërbimet, ose;

b) banesën ose rezidencën e zakonshme, në mungesë të një selie të veprimtarisë ekonomike apo të një vendndodhjeje të qëndrueshme.

2. Vendi i furnizimit të shërbimit është në Republikën e Shqipërisë, nëse marrësi i shërbimit është një person i patatueshëm ndërsa furnizuesi i shërbimit, një person i tatueshëm, ka në Republikën e Shqipërisë:

a) selinë e veprimtarisë së tij ekonomike ose një vendndodhje të qëndrueshme, nga e cila janë ofruar shërbimet ose;

b) banesën ose rezidencën e zakonshme, në mungesë të një selie të veprimtarisë ekonomike apo të një vendndodhjeje të qëndrueshme.

Neni 25
Përjashtime nga rregulli i përgjithshëm

Ndryshe nga sa parashikohet në pikat 1 dhe 2, të nenit 24, të këtij ligji, pavarësisht nëse marrësi është person i tatueshëm ose person i patatueshëm, si dhe pavarësisht vendit ku ndodhet marrësi i shërbimit, vendi i furnizimit të shërbimeve për:

a) furnizimin e shërbimeve të lidhura me një pasuri të patundshme, përfshirë shërbimet e ekspertëve dhe agjentëve imobiliarë, furnizimin e strehimit në sektorin hotelier apo në sektorë të ngjashëm me të, si kampe pushimi ose vende të krijuara për t'u përdorur si vende kampingu, dhënien e të drejtave të përdorimit të pasurive të paluajtshme dhe shërbimet për përgatitjen e bashkërendimin e punimeve të ndërtimit, të tilla si shërbimet e arkitektëve dhe firmave që mbikëqyrin kryerjen e punimeve (supervizim) është në Republikën e Shqipërisë, nëse pasuria e paluajtshme ndodhet në Republikën e Shqipërisë;

b) furnizimin e transportit të pasagjerëve është në Republikën e Shqipërisë proporcionalisht me distancën e përshkruar;

c) furnizimin e shërbimeve të restorantit dhe shërbimeve të furnizimit me ushqim është në Republikën e Shqipërisë ku këto shërbime janë kryer fizikisht;

ç) furnizimin e shërbimeve të restorantit dhe shërbimeve të furnizimit me ushqim, të cilat kryhen në bordin e anijeve, avionëve dhe trenave gjatë transportit të pasagjerëve është në Republikën e Shqipërisë nëse vendi i nisjes së transportit të pasagjerëve është në Republikën e Shqipërisë;

Në rastin e një udhëtimi vajtje-ardhje, pjesa e kthimit cilësohet si një transaksion transporti më vete;

d) furnizimin e shërbimit të dhënies me qira afatshkurtër të një mjeti transporti është në Republikën e Shqipërisë nëse ky mjet transporti vihet faktikisht në dispozicion të klientit në Republikën e Shqipërisë.

Për qëllime të kësaj shkronje, me "afatshkurtër" kuptohet zotërimi i vazhdueshëm ose përdorimi i mjeteve të transportit gjatë një periudhe kohore jo më shumë se tridhjetë ditë dhe në rastin e mjeteve lundruese apo fluturuese, jo më shumë se nëntëdhjetë ditë.

Neni 26
Përjashtime nga rregulli për shërbime kundrejt personave të tatueshëm

Ndryshe nga sa parashikohet në pikën 1, të nenit 24, të këtij ligji, për furnizimin kundrejt një personi të tatueshëm të shërbimeve, për qëllime të ngjarjeve kulturore, artistike, sportive, shkencore, edukative, zbavitëse apo të ngjashme me këto, si ekspozita dhe panaire, si dhe shërbime mbështetëse, të lidhura me pranimin në këto aktivitete, vendi i furnizimit të shërbimeve është në Republikën e Shqipërisë nëse këto aktivitete zhvillohen faktikisht në Republikën e Shqipërisë.

Neni 27
Përjashtimi nga rregulli për shërbimet e furnizuara nga ndërmjetësi

Ndryshe nga sa parashikohet në pikën 2, të nenit 24, të këtij ligji, vendi i furnizimit të shërbimit të kryer nga një person ndërmjetës, që vepron në emër dhe për llogari të një personi tjetër, ndaj një personi të patatueshëm, është në Republikën e Shqipërisë nëse vendi i transaksionit kryesor, siç përcaktohet në këtë ligj, është në Shqipëri.

Neni 28
Përjashtime nga rregulli për shërbime kundrejt personave të patatueshëm

Ndryshe nga sa parashikohet në pikën 2, të nenit 24, të këtij ligji, vendi i furnizimit të shërbimeve ndaj personave të patatueshëm për:

a) furnizimin e transportit të mallrave është në Republikën e Shqipërisë, proporcionalisht me distancën e përshkruar;

b) furnizimin e shërbimeve dhe shërbimeve mbështetëse për qëllim të aktiviteteve kulturore, artistike, sportive, shkencore, edukative, zbavitëse apo aktiviteteve të ngjashme, të tilla si panairet dhe ekspozitat, përfshirë furnizimin e shërbimeve të organizatorëve të këtyre aktiviteteve, është në Shqipëri ku këto aktivitete kryhen faktikisht;

c) furnizimin e shërbimeve mbështetëse të transportit, si ngarkim, shkarkim, mirëmbajtje dhe aktivitete të ngjashme është në Republikën e Shqipërisë ku këto shërbime janë kryer fizikisht;

ç) furnizimin e shërbimeve të ekspertizave ose punëve të kryera mbi pasurinë e trupëzuar të luajtshme është në Republikën e Shqipërisë ku këto shërbime janë kryer fizikisht;

d) furnizimin e shërbimit të dhënies me qira të një mjeti transporti, përjashtuar atë afatshkurtër, është në Republikën e Shqipërisë ku ky klient është i vendosur, ka adresën e përhershme ose banon zakonisht;

Sidoqoftë, vendi i furnizimit të shërbimit të dhënies me qira të një jahti apo mjeti të ngjashëm lundrues, të ndryshme nga ajo afatshkurtër, është në Republikën e Shqipërisë ku mjeti vihet faktikisht në dispozicion të klientit dhe njëkohësisht shërbimi jepet nga furnizuesi i këtij shërbimi në vendin e aktivitetit ose një vendndodhjeje të qëndrueshme në Republikën e Shqipërisë.

Për qëllime të kësaj shkronje, me "afatshkurtër" kuptohet zotërimi i vazhdueshëm ose përdorimi i mjeteve të transportit gjatë një periudhe kohore jo më shumë se tridhjetë ditë dhe në rastin e mjeteve lundruese, jo më shumë se nëntëdhjetë ditë.

Neni 29
Furnizimi i shërbimeve të telekomunikacionit, të transmetimit dhe shërbimeve elektronike ndaj personave të patatueshëm

1. Në përjashtim nga pika 2, e nenit 24, të këtij ligji, pavarësisht se ku është i vendosur personi i tatueshëm furnizues i shërbimeve të mëposhtme, vendi i furnizimit të këtyre shërbimeve është në vendin ku personi i patatueshëm, i cili merr shërbimin, është i vendosur, ka adresën e përhershme apo banon zakonisht. Këto shërbime janë të detajuara si më poshtë:

a) furnizimi i shërbimeve të telekomunikacionit;

b) furnizimi i shërbimeve të transmetimit të radios dhe ato televizive;

c) furnizimi i website-ve, web-hosting, mirëmbajtjes në distancë të programeve dhe pajisjeve;

ç) furnizimi me software dhe përditësimi i tyre;

d) furnizimi i imazheve, teksteve dhe informacioneve dhe vlefshmëria e bazës të të dhënave (database);

dh) furnizimi me muzikë, filma dhe lojëra, përfshirë lojërat e fatit dhe bastet, si dhe transmetimet e ngjarjeve politike, kulturore, artistike, sportive, shkencore dhe argëtuese;

e) furnizimi i shërbimit të mësimdhënies në distancë;

2.Kur furnizuesi i shërbimit dhe marrësi i tij komunikojnë përmes postës elektronike, kjo nuk do të thotë që shërbimi i furnizuar është një shërbim i furnizuar elektronikisht.

Neni 30
Furnizimi i shërbimeve ndaj personave të patatueshëm në Shqipëri

1. Në përjashtim nga pika 2 e nenit 24, të këtij ligji, pavarësisht se ku është i vendosur personi i tatueshëm furnizues i shërbimeve të mëposhtme, vendi i furnizimit të këtyre shërbimeve është në vendin ku personi i patatueshëm, i cili merr shërbimin, është i vendosur, ka adresën e përhershme apo banon zakonisht. Këto shërbime janë të detajuara si më poshtë:

a) transferimet dhe dhënia e të drejtave të autorit, patentave, licencave, markës tregtare dhe të drejtave të tjera të ngjashme;

b) shërbime publiciteti;

c) shërbimet e konsulentëve, inxhinierëve, firmave konsulente, avokatëve, kontabilistëve dhe shërbime të tjera të ngjashme, si dhe përpunimi i të dhënave dhe dhënia e informacionit;

ç) detyrimet për të mos ushtruar, pjesërisht ose tërësisht, një aktivitet tregtar apo një të drejtë të përmendur në këtë nen;

d) transaksionet bankare, financiare dhe të sigurimit, ku përfshihet edhe risigurimi, me përjashtim të marrjes me qira të kasafortave;

dh) furnizimi me personel;

e) dhënia me qira e pasurive materiale të luajtshme, me përjashtim të të gjitha mjeteve të transportit;

ë) shërbimi i lejimit në sistemin e gazit natyror ose në çdolloj rrjeti të lidhur me një sistem të tillë, në sistemin e elektricitetit ose rrjeteve të ngrohje-ftohjes, ose transmetimi apo shpërndarja përmes këtyre sistemeve a rrjeteve dhe furnizimi i shërbimeve që lidhen direkt me to.

2. Kur furnizuesi i një shërbimi dhe klienti komunikojnë përmes postës elektronike, kjo në vetvete nuk do të thotë që shërbimi i furnizuar është një shërbim i furnizuar elektronikisht.

KREU V
LINDJA E TATIMIT, KËRKUESHMËRIA

Neni 31
Përkufizime

Për qëllime të këtij ligji, me termat e mëposhtëm kuptohet:

a)“Lindja e tatimit” është ngjarja, nëpërmjet së cilës përmbushen kushtet ligjore të domosdoshme për të kërkuar tatimin mbi vlerën e shtuar;

b)“Kërkueshmëria e tatimit” është e drejta që ka autoriteti tatimor, bazuar në këtë ligj, që duke filluar nga një moment i caktuar t’i kërkojë tatimin mbi vlerën e shtuar personit përgjegjës për pagimin e këtij tatimi edhe nëse momenti i pagesës mund të shtyhet.

SEKSIONI 1
LINDJA DHE KËRKUESHMËRIA E TATIMIT PËR FURNIZIMET E MALLRAVE DHE SHËRBIMEVE

Neni 32
Rregulli i përgjithshëm

Lindja e tatimit ndodh dhe TVSH-ja bëhet e kërkueshme kur furnizimi i mallrave ose shërbimeve kryhet, përveç kur është parashikuar ndryshe në këtë ligj.

Neni 33
Rregulla të veçanta

1. Në qoftë se kryhen pagesa pjesore ose pagesa të njëpasnjëshme për furnizimet e mallrave ose të shërbimeve, përveç furnizimeve të mallrave, që kanë si objekt qiradhënien e një malli për një periudhë të caktuar ose shitjen e mallrave, sipas pagesave me këste, siç përcaktohet në shkronjën "b", të pikës 2, të nenit 7, të këtij ligji, këto furnizime mallrash ose shërbimesh konsiderohen të kryera në përfundim të çdo periudhe, së cilës i referohen pagesat.
2. Furnizimet e mallrave dhe shërbimeve të kryera në mënyrë të vazhdueshme, brenda një periudhe kohore, përfshirë operacionet e ndërtimit, konsiderohen të kryera në të njëjtin muaj, në të cilin lëshohet fatura në përputhje me pikën 5, të nenit 99, të këtij ligji.
3. Për çdo pagesë të kryer para se të kryhet furnizimi i mallit ose para përfundimit të furnizimit të shërbimit, TVSH-ja mbi pagesën lind dhe bëhet e kërkueshme në momentin e arkëtimit të shumës së paguar.
4. Në rastin kur fatura tatimore është lëshuar përpara furnizimit, TVSH-ja bëhet e kërkueshme në momentin kur është lëshuar fatura.

SEKSIONI 2
LINDJA DHE KËRKUESHMËRIA E TATIMIT PËR IMPORTIMIN E MALLRAVE

Neni 34
Rregulli i përgjithshëm

Lindja e tatimit ndodh dhe TVSH-ja bëhet e kërkueshme kur importimi i mallrave është kryer në kuptim të nenit 14, të këtij ligji.

Neni 35
Rregulla të veçanta për importimin

Në përjashtim nga neni 34, i këtij ligji, mallrat, të cilat në momentin e hyrjes në Republikën e Shqipërisë, nuk janë në qarkullim të lirë, por i nënshtrohen ndonjërit prej regjimeve të parashikuara në nenet 64 dhe 65, të këtij ligji, ose nën regjime të përkohshme importimi, me përjashtim total nga taksat doganore, ose regjimit të transitit, lindja e tatimit ndodh dhe TVSH-ja bëhet e kërkueshme kur këto mallra çlirohen nga regjimet ose situatat e sipërpërmendura.

KREU VI
VLERA E TATUESHME

Neni 36
Përkufizime

1. Për qëllime të këtij ligji, me termin "vlerë tregu" kuptohet shuma e plotë që blerësi, për të përfituar mallrat apo shërbimet në të njëjtën fazë të tregtimit në të cilën furnizimi kryhet, duhet t'i paguajë në kushtet e konkurrencës së barabartë furnizuesit të mallit ose shërbimit, i cili vepron si i pavarur në kushtet e tregut në territorin e Republikën e Shqipërisë, në të cilin ky furnizim është subjekt i tatimit.

2. Në qoftë se nuk mund të sigurohen vlera të krahasueshme për furnizimet e mallrave ose shërbimeve, atëherë me termin "vlerë tregu" kuptohen shumat e mëposhtme:

a) për mallrat, një shumë jo më e vogël se çmimi i blerjes së mallit apo të mallrave të ngjashme ose, në mungesë të çmimit të blerjes, sa vlera e kostos e përcaktuar në kohën e furnizimit.

b) në rastin e shërbimeve, një shumë jo më e vogël se kostoja e plotë e kryerjes së shërbimit prej personit të tatueshëm.

SEKSIONI 1
FURNIZIMET E MALLRAVE DHE SHËRBIMEVE

Neni 37
Rregulli i përgjithshëm

Për furnizimet e mallrave dhe shërbimeve, përveç atyre të parashikuara nga pika 1 deri në pikën 3, të nenit 38, të këtij ligji, vlera e tatueshme duhet të përfshijë gjithçka që përbën vlerën korresponduese që furnizuesi i mallit ose shërbimit merr ose do të marrë nga blerësi, klienti apo një i tretë, në këmbim të furnizimit, përfshirë edhe subvencionet e lidhura drejtpërdrejt me çmimin e këtyre furnizimeve, përveç TVSH-së.

Neni 38
Rregulla të veçanta

1. Në rastet kur personi i tatueshëm përdor ose disponon mallrat që i përkasin pasurisë së sipërmarrjes së tij ose kur mallrat mbahen nga një person i tatueshëm ose pasardhësit e tij, kur veprimtaria e tij ekonomike e tatueshme përfundon, siç parashikohet në shkronjat "a", "b", "c", "ç", të pikës 2, të nenit 9, të këtij ligji, vlera e tatueshme përbëhet prej çmimit të blerjes së këtyre mallrave apo të mallrave të ngjashme ose, në mungesë të çmimit të blerjes, nga vlera e kostos, e përcaktuar në momentin, në të cilin kryhen veprimet e përdorimit, disponimit apo mbajtjes.

2. Në rastin e furnizimit të shërbimit, të parashikuar në shkronjat "a" dhe "b", të pikës 2, të nenit 12, të këtij ligji, kur mallrat që i përkasin pasurisë së biznesit përdoren për qëllime private ose shërbimet kryhen pa pagesë, vlera e tatueshme përbëhet nga kostoja e plotë e shpenzuar nga personi i tatueshëm për kryerjen e shërbimeve.

3. Për rastin e furnizimit të shërbimit të parashikuar në shkronjën "c", të pikës 2, të nenit 12, të këtij ligji, të kryera nga personi i tatueshëm për nevojat e biznesit së vet, vlera e tatueshme do të jetë vlera e tregut e shërbimit të furnizuar.

4. Nëse furnizimi këmbehet në mallra/shërbime ose pjesërisht në para dhe pjesërisht në mallra/shërbime (natyrë), vlera e tatueshme e furnizimit duhet të jetë vlera e tregut e mallrave ose shërbimeve të pranuara, e llogaritur në datën, në të cilën tatimi bëhet i kërkueshëm.

Neni 39
Vlera e tatueshme

1. Në vlerën e tatueshme përfshihen elementet e mëposhtme:

a) tatimet, taksat, detyrimet, tarifat dhe pagesa të ngjashme, me përjashtim të TVSH-së.

b) shpenzimet dytësore, të tilla si shpenzimet komisionere, të ambalazhimit, të transportit dhe të sigurimit që furnizuesi ia ngarkon blerësit ose klientit.

c)për qëllime të shkronjës "b", të kësaj pike, konsiderohen gjithashtu si shpenzime dytësore ato të parashikuara në marrëveshje të veçanta.

2. Në vlerën e tatueshme të furnizimit përfshihet vlera e ambalazheve kur ato janë të pakthyeshme.

Vlera e ambalazheve të kthyeshme nuk përfshihet në vlerën e tatueshme të furnizimit, përveç kur ambalazhet e kthyeshme nuk janë kthyer nga blerësi.

3. Në qoftë se elementet që përcaktojnë vlerën e tatueshme ose vlera e tatueshme është e shprehur në një monedhë të ndryshme nga monedha kombëtare e Republikës së Shqipërisë, i cili është vendi në të cilin bëhet vlerësimi, vlera e tatueshme shprehet në monedhën kombëtare ekuivalente me kursin e këmbimit të zbatuar nga Banka e Shqipërisë në momentin, në të cilin tatimi bëhet i kërkueshëm.

Neni 40
Elemente që nuk përfshihen në vlerën e tatueshme

1. Në vlerën e tatueshme nuk përfshihen elementet e mëposhtme:

a) uljet e çmimit për rastet e zbritjes për pagesa të hershme të kryera për furnizimin;

b) uljet dhe reduktimet e çmimit që i bëhen blerësit apo klientit dhe të përfituara nga ai në momentin, në të cilin kryhet furnizimi;

c) shumat që ka marrë një person i tatueshëm nga ana e blerësit apo klientit të tij si rimbursim për shpenzimet e bëra në emër dhe për llogari të këtyre të fundit dhe të regjistruara në kontabilitetin e personit të tatueshëm si llogari provizore;

Personi i tatueshëm duhet të paraqesë prova të shumës efektive të shpenzimeve, sipas shkronjës "c", të kësaj pike, dhe nuk mund të kryejë zbritje të TVSH-së që mund të jetë llogaritur mbi to.

2. Ministri i Financave ka të drejtë të përcaktojë me udhëzim rregulla të veçanta për zbatimin e shkronjës "c", të pikës 1, të këtij neni.

Neni 41
Saktësimi i vlerës së tatueshme

1. Në rast anulimi, tërheqjeje, zgjidhjeje e reduktimi të çmimit që bëhet pas momentit, në të cilin kryhet furnizimi, vlera e tatueshme reduktohet në përputhje me këtë ligj.

2. Ministri i Financave përcakton me udhëzim procedurën dhe rregullat për saktësimin e vlerës së tatueshme, në përputhje me pikën 1, të këtij neni.

Neni 42
Masat për të parandaluar shmangien dhe evazionin tatimor

1. Për furnizimet e mallrave dhe shërbimeve, në rastet e mëposhtme, për blerës ose klientë, me të cilët furnizuesit kanë marrëdhënie familjare apo lidhje të tjera të ngushta personale, menaxhimi, pronësie, anëtarësie, financiare apo juridike, vlera e tatueshme është e barabartë me vlerën e tregut në qoftë se:

a) vlera korresponduese është më e vogël se vlera e tregut dhe blerësi ose klienti nuk gëzon plotësisht të drejtën e zbritjes së TVSH-së, sipas neneve 68, 69, 70, 71, 72, 73 e 74, të këtij ligji;

b) vlera korresponduese është më e vogël se vlera e tregut dhe furnizuesi nuk gëzon plotësisht të drejtën e zbritjes së TVSH-së mbi bazën e neneve 68, 69, 70, 71, 72, 73 e 74, të këtij ligji, dhe kur furnizimi është i përjashtuar mbi bazën e neneve 51, 53 dhe 54, të këtij ligji;

c) vlera korresponduese është më e madhe se vlera e tregut dhe furnizuesi nuk gëzon plotësisht të drejtën e zbritjes mbi bazën e neneve 68, 69, 70, 71, 72, 73 e 74, të këtij ligji.

2. Dispozitat e parashikuara në pikën 1, të këtij neni, zbatohen gjithashtu për marrëdhëniet midis punëdhënësit dhe punëmarrësit ose familjes së punëmarrësit apo personave të tjerë të lidhur ngushtësisht me të.

Neni 43
Vlera e tatueshme e arit të përpunuar

Vlera e tatueshme e arit të përpunuar nuk përfshin vlerën e arit të përdorur si lëndë e parë. Mënyra e llogaritjes së vlerës së tatueshme të arit të përpunuar përcaktohet me udhëzim të Ministrit të Financave.

SEKSIONI 2
IMPORTIMI I MALLRAVE

Neni 44
Vlera e tatueshme në importimin e mallrave

1. Vlera e tatueshme e mallrave të importuara përbëhet prej vlerës së përcaktuar në import nga autoriteti doganor, mbi bazën e legjislacionit doganor në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

2. Vlera e tatueshme e mallrave të importuara përfshin, gjithashtu, nëse nuk janë përfshirë elementet e mëposhtme:

a) taksat, tatimet, detyrimet, tarifat dhe pagesa të tjera të detyrueshme për t'u paguar jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë, si edhe ato të detyrueshme, si rezultat i importimit, me përjashtim të TVSH-së.

b) shpenzimet dytësore, të tilla si shpenzimet komisionere, të ambalazhimit, të transportit dhe të sigurimit që ndodhin deri në momentin e hyrjes së mallit në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë.

3. Vlera e tatueshme për arin e përpunuar, të importuar, përcaktohet sipas pikave 1 dhe 2, të këtij neni, pa përfshirë vlerën e arit të përdorur si lëndë e parë. Mënyra e llogaritjes përcaktohet me udhëzim të Ministrit të Financave, në zbatim të këtij ligji.

Neni 45
Elementet që nuk përfshihen në vlerën e tatueshme në import

Në vlerën e tatueshme të mallrave të importuara nuk përfshihen elementet e mëposhtme:
a)uljet e çmimit për rastet e zbritjes për pagesa të hershme, të kryera për furnizimin.
b)uljet dhe reduktimet e çmimit që i bëhen blerësit apo klientit dhe të përfituara nga ai në momentin, në të cilin kryhet importimi.

Neni 46
Dispozita të tjera

1. Për mallrat që janë eksportuar përkohësisht jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë dhe që në vijim importohen përsëri në Republikën e Shqipërisë pasi i janë nënshtruar ndërkohë riparimit, transformimit, përshtatjes, punimit ose ripunimit jashtë Republikës së Shqipërisë, vlera e tatueshme është e njëjtë me atë që do të ishte aplikuar nëse riparimi, përpunimi, përshtatja, punimi ose ripunimi do të kishin ndodhur në territorin e Republikës së Shqipërisë.

2. Në qoftë se elementet që duhet të mbahen parasysh për përcaktimin e vlerës së tatueshme për importimet janë të shprehura në një monedhë të ndryshme nga ajo e monedhës kombëtare në Republikën e Shqipërisë, kursi i këmbimit për llogaritjen e vlerës së tatueshme në doganë bëhet në përputhje me legjislacionin doganor në Republikën e Shqipërisë.

KREU VII
SHKALLA TATIMORE

Neni 47
Aplikimi i shkallës së TVSH-së

1. Shkalla e TVSH-së, e aplikueshme për furnizimet e tatueshme, është shkalla e TVSH-së në fuqi në momentin e lindjes së tatimit, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe.

2. Shkalla e TVSH-së e aplikueshme është ajo në fuqi në momentin, në të cilin tatimi bëhet i kërkueshëm, për rastet e parashikuara, sipas pikave 3 dhe 4, të nenit 33, të këtij ligji.

Neni 48
Shkalla standard

Shkalla standarde e tatimit mbi vlerën e shtuar për furnizimet e mallrave dhe shërbimeve, e cila aplikohet si një përqindje e vlerës së tatueshme, është 20 për qind.

Neni 49
Shkallët e reduktuara

1. Përveç shkallës standarde të TVSH-së, kur parashikohet në këtë ligj, mund të aplikohet shkalla e reduktuar e TVSH-së, e cila aplikohet si një përqindje e vlerës së tatueshme.

2. Shuma e TVSH-së që rezulton nga aplikimi i shkallës së reduktuar të TVSH-së lejon normalisht zbritjen e shumës së TVSH-së, së cilës i njihet e drejta e zbritjes, siç përcaktohet në nenet 68, 69, 70, 71, 72, 73 e 74, të këtij ligji.

3. Shkalla e reduktuar e tatimit mbi vlerën e shtuar, e cila aplikohet për furnizimin e shërbimit të akomodimit në strukturat akomoduese, sipas kategorive të përcaktuara në legjislacionin e fushës së turizmit, është 6 për qind. Kushtet, kriteret dhe procedurat për zbatimin e kësaj pike përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

4. Përjashtimisht sa përcaktohet në pikën 3, të këtij neni, shkalla e reduktuar e tatimit mbi vlerën e shtuar 6 % aplikohet për çdo furnizim shërbimi të ofruar brenda strukturave akomoduese "Hotel/Resort me pesë yje, status special", sipas përcaktimit në legjislacionin e fushës së turizmit dhe që janë mbajtës të një marke tregtare të regjistruar dhe njohur ndërkombëtarisht "*brand name*".

Kushtet, kriteret dhe procedurat për zbatimin e kësaj pike përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

5. Për strukturat, të cilat zhvillojnë veprimtari pritëse të certifikuar si "agroturizëm", sipas legjislacionit në fuqi në fushën e turizmit, aplikohet shkalla e reduktuar e tatimit mbi vlerën e shtuar 6 për qind për furnizimin e shërbimit të akomodimit dhe restorantit, me përjashtim të pijeve. Personi i tatueshëm, që aplikon shkallën e reduktuar të tatimit mbi vlerën e shtuar 6 për qind, është personi i regjistruar me NIPT/NUIS, vetëm për zhvillimin e veprimtarisë pritëse të certifikuar si "agroturizëm"

6. Shkalla e reduktuar e tatimit mbi vlerën e shtuar, e cila aplikohet për furnizimin e shërbimit të reklamave nga media audiovizive, është 6 për qind.

7. Shkalla e reduktuar e tatimit mbi vlerën e shtuar, e cila aplikohet për furnizimin e mjeteve të transportit publik të licencuar të udhëtarëve me autobus me nëntë plus një vende ose më shumë, vetëm me motor elektrik, është 6 për qind.

(Ndryshuar me Ligj Nr. 85/2019 datë 18.12.2019. Botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 184 datë 31.12.2019)

8. Shkalla e reduktuar e tatimit mbi vlerën e shtuar, e cila aplikohet për furnizimin e librave të çdo lloji, është 6 për qind.

(Ndryshuar me Ligj nr. 71/2017, datë 27/04/2017. Botuar në Fletoren Zyrtare nr. 113, datë 22 maj 2017)
(Ndryshuar me Ligj nr. 107/2017, datë 30/11/2017. Botuar në Fletoren Zyrtare nr. 222, datë 19.12.2017)
(Ndryshuar me Ligj nr. 40/2018, datë 09.07.2018. Botuar në Fletoren Zyrtare nr. 111, datë 30.07.2018. Hyn në fuqi 01.01.2019)
(Ndryshuar me Ligj nr. 96/2018, datë 03.12.2018. Botuar në Fletoren Zyrtare nr.187, datë 28.12.2018)

Neni 50
Shkalla e TVSH-së në importimin e mallrave

Shkalla e TVSH-së, e aplikueshme për importimet e mallrave, është ajo që aplikohet në territorin e Republikës së Shqipërisë për shitjen e të njëjtit mall.

KREU VIII
PËRJASHTIMET, FURNIZIMET ME SHKALLË ZERO, EKSPORTET

SEKSIONI 1
FURNIZIMET E PËRJASHTUARA

Neni 51
Përjashtimi i disa veprimtarive me interes të përgjithshëm

Janë furnizime të përjashtuara nga TVSH-ja transaksionet me interes të përgjithshëm si më poshtë:

a) furnizimi i shërbimit postar dhe i mallrave aksesore në furnizimin e këtij shërbimi, që janë në përputhje me shërbimin universal postar të kryer nga shërbimi publik postar në Republikën e Shqipërisë, përveç transportit të personave dhe telekomunikacionet;

b) furnizimi i barnave, pajisjeve mjekësore të implantueshme aktive dhe pajisjeve mjekësore të implantueshme;

c) furnizimi i shërbimeve shëndetësore dhe veprimeve të lidhura ngushtë me to, që kanë për qëllim mbrojtjen e shëndetit të shtetasve, përfshirë parandalimin, diagnozën, trajtimin, kurimin e sëmundjes apo çrregullimeve shëndetësore dhe rehabilitimin, nga institucionet shëndetësore publike ose private, të njohura si të tilla nga autoriteti kompetent shëndetësor;

ç) furnizimet e shërbimeve shëndetësore, të ofruara për qëllime të kujdesit për shëndetin, në kuadër të ushtrimit të profesionit mjekësor ose paramjekësor, të njohur si të tillë dhe të licencuar, sipas legjislacionit në fuqi për licencimin;

d) furnizimi i organeve, gjakut dhe të qumështit njerëzor;

dh) furnizimet e shërbimeve shëndetësore, të kryera në kuadrin e profesionit të tyre nga stomatologët dhe laborantët dentarë;

e) furnizimi i shërbimeve të kryera nga grupe të pavarura të personave që ushtrojnë një veprimtari të përjashtuar nga TVSH-ja, ose për të cilën nuk kanë cilësinë e një personi të tatueshëm, me qëllimin për t'u dhënë anëtarëve të tyre shërbime drejtpërdrejt të nevojshme për ushtrimin e asaj veprimtarie, kur grupime të tilla u kërkojnë anëtarëve të tyre vetëm rimbursimin e shumës së saktë të pjesës së shpenzimeve të përbashkëta që u takon atyre, me kusht që ky përjashtim të mos sjellë shtrembërime të konkurrencës;

ë) furnizimi i shërbimeve dhe mallrave ngushtësisht të lidhura me ndihmën dhe asistencën sociale, përfshirë veprimet që kryejnë shtëpitë e kujdesit për të moshuarit, të kryera nga institucione publike apo nga organizma pa qëllim fitimi, me karakter social, të njohura nga autoriteti kompetent në Republikën e Shqipërisë dhe me çmime të miratuara nga ky autoritet. Në rast se këto çmime nuk janë të miratuara, veprimtaria e organizatës përfiton këtë përjashtim, me kusht që të praktikojë çmime më të ulëta se ato që kërkohen për veprime të ngjashme nga ana e subjekteve të TVSH-së dhe të mos sjellë shtrembërime të konkurrencës, sipas përcaktimeve të bëra me vendim të Këshillit të Ministrave;

f) furnizimi i shërbimeve dhe mallrave ngushtësisht të lidhura me mbrojtjen e fëmijëve dhe të rinjve, të kryera nga institucione publike apo nga organizma pa qëllim fitimi, me karakter social, të njohura nga autoriteti kompetent në Republikën e Shqipërisë dhe me çmime të miratuara nga ky autoritet. Në rast se këto çmime nuk janë të miratuara, veprimtaria e organizatës përfiton këtë përjashtim, me kusht që të praktikojë çmime më të ulëta se ato që kërkohen për veprime të ngjashme nga ana e subjekteve të TVSH-së dhe të mos sjellë shtrembërime të konkurrencës, sipas përcaktimeve të bëra me vendim të Këshillit të Ministrave;

g) furnizimi i shërbimeve të edukimit të fëmijëve dhe të rinjve, të mësimdhënies shkollore apo universitare, formimit profesional dhe rikualifikimit, përfshirë furnizimin e shërbimeve dhe mallrave ngushtësisht të lidhura me to nga institucionet arsimore, publike dhe private, të njohura si të tilla nga autoriteti kompetent shtetëror, në përputhje me legjislacionin përkatës të fushës;

gj) furnizimi i shërbimeve të mësimdhënies shkollore apo universitare, të kryera privatisht nga mësuesit;

h) furnizimi i shërbimit të vënies në dispozicion të personelit nga institucionet fetare apo filozofike, për qëllim të veprimtarive të parashikuara në shkronjat "b", "c" "ë", "f" dhe "g", të këtij neni, dhe në kuadër të mirëqenies shpirtërore;

i) furnizimi i shërbimeve dhe mallrave ngushtësisht të lidhura me to, të kryera për anëtarët e vet në interesin e tyre kolektiv, me pagimin e kuotave të caktuara, në përputhje me statutin, nga ana e organizatave jofitimprurëse, që kanë objektiva të natyrës politike, sindikaliste, fetare, patriotike, filozofike, filantropike apo qytetare, të krijuara në përputhje me ligjet specifike që rregullojnë veprimtarinë e tyre, me kusht që ky përjashtim të mos shkaktojë shtrembërime të konkurrencës;

j) furnizimi i shërbimeve të caktuara, të lidhura ngushtë me ushtrimin e sportit ose të edukimit fizik, që u ofrohen personave që marrin pjesë në ushtrimin e sportit apo të edukimit fizik nga organizatat jofitimprurëse, sipas ligjit për sportin, të regjistruara sipas ligjit për organizatat jofitimprurëse. Këto organizata sportive duhet të jenë të njohura nga autoriteti kompetent në Republikën e Shqipërisë dhe të kenë çmime të miratuara nga ky autoritet. Në rast

se këto çmime nuk janë të miratuara, veprimtaria e organizatës përfiton këtë përjashtim me kusht që të praktikojë çmime më të ulëta se ato që kërkohen për veprime të ngjashme nga ana e subjekteve të TVSH-së dhe të mos sjellë shtrembërime të konkurrencës, sipas përcaktimeve të bëra me vendim të Këshillit të Ministrave;

k) furnizimi i shërbimeve të caktuara kulturore dhe mallrave që lidhen ngushtësisht me to, të kryera nga ana e institucioneve publike apo nga organizma të tjerë kulturorë, pa qëllim fitimi, të regjistruar sipas ligjit për organizatat jofitimprurëse, me karakter social, të njohura nga autoriteti kompetent në Republikën e Shqipërisë dhe me çmime të miratuara nga ky autoritet. Në rast se këto çmime nuk janë të miratuara, veprimtaria e organizatës përfiton këtë përjashtim, me kusht që të praktikojë çmime më të ulëta se ato që kërkohen për veprime të ngjashme nga ana e subjekteve të TVSH-së dhe të mos sjellë shtrembërime të konkurrencës, sipas përcaktimeve të bëra me vendim të Këshillit të Ministrave;

l) furnizimi i shërbimeve dhe mallrave të kryera nga organizata, veprimtaria e të cilave përjashtohet nga tatimi, mbi bazën e shkronjave "b", "c" , "ë", "f", "g", "i", "j" dhe "k", të këtij neni, në lidhje me organizime për mbledhje fondesh ekskluzivisht për përfitimin e tyre, me kusht që përjashtimi të mos jetë i atillë sa të sjellë shtrembërime të konkurrencës;

Në funksion të kësaj shkronje, Këshilli i Ministrave përcakton kufizimet e nevojshme për sa i përket numrit të shfaqjeve apo shumës së të ardhurave për të përfituar të drejtën e përjashtimit;

ll) furnizimi i transportit të të sëmurëve apo të plagosurve me automjete të krijuara posaçërisht për këtë qëllim nga ana e organizmave të autorizuar posaçërisht;

m) veprimtaritë e kryera nga radiotelevizionet publike shqiptare, përveç veprimtarive me natyrë tregtare.

n) furnizimi i makinave bujqësore. Lista e makinave bujqësore përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave;

nj) furnizimi i inputeve bujqësore, siç janë plehrat kimike, pesticidet, farat dhe fidanët, përveç hormoneve të klasifikuar në kodet 2937 të NKM-së. Lista e kategorive të imputeve bujqësore përcaktohet vendim të Këshillit të Ministrave;

o) furnizimi i shërbimeve veterinare, me përjashtim të shërbimeve veterinare për kafshët shtëpiake.

(Ndryshuar me Ligj nr. 96/2018, datë 03.12.2018. Botuar në Fletoren Zyrtare nr.187, datë 28.12.2018)

p) furnizimi i automjeteve vetëm me motor elektrik, të reja, me zero km e që nuk janë regjistruar më parë për qarkullim në asnjë shtet tjetër, përveç atyre të përcaktuara në pikën 7, të nenit 49, të ligjit.

(Shtuar me Ligj Nr. 85/2019 datë 18.12.2019. Botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 184 datë 31.12.2019)

Neni 52

Kufizime të së drejtës së përjashtimit

1. Furnizimet e mallrave dhe shërbimeve nuk përjashtohen nga TVSH-ja, siç parashikohet në shkronjat "b", "c" , "ë", "f", "g", "i", "j" dhe "k", të nenit 51, të këtij ligji, nëse ato furnizime nuk janë të domosdoshme për kryerjen e furnizimeve të përjashtuara.

2. Furnizimet e mallrave dhe shërbimeve, të parashikuara në shkronjat "b", "c" , "ë", "f", "g", "i", "j" dhe "k", të nenit 51, të këtij ligji, nuk përjashtohen nga TVSH-ja, nëse nëpërmjet furnizimit të tyre realizohen të ardhura shtesë duke konkurruar drejtpërdrejt me transaksionet e kryera nga sipërmarrjet tregtare, subjekte të TVSH-së.

Neni 53
Përjashtime për disa veprimtari të tjera

Janë furnizime të përjashtuara nga TVSH-ja transaksionet e mëposhtme:

a) shërbimet e sigurimit dhe të risigurimit, përfshirë kryerjen e shërbimeve të ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime nga agjentët dhe brokerat e sigurimit;

b) dhënia dhe negocimi i kredive, si edhe menaxhimi i kredive nga ana e kredidhënësit;

c) negocimi ose çdo marrëveshje tjetër në garantimin e kredive ose çdo sigurim tjetër për paratë, si edhe menaxhimi i garancive të kredive nga ana e kredidhënësit;

ç) transaksionet, përfshirë negocimin lidhur me veprimet e këmbimit, llogaritë e depozitave, llogaritë rrjedhëse, furnizimin e likuiditeteve nëpërmjet pagesave, transfertave, marrje-dhëniet e borxhit, çeqet dhe instrumentet e tjera të negociueshme, përveç shërbimit të mbledhjes së borxhit;

d) transaksionet, përfshirë negocimin lidhur me valutën, kartëmonedhat apo monedhat e përdorura si mjete ligjore pagese, me përjashtim të monedhave dhe të kartëmonedhave për koleksion, që do të thotë monedha ari, argjendi apo monedha të tjera metali ose kartëmonedha që nuk përdoren normalisht si mjet ligjor pagese ose monedha që paraqesin interes numizmatik;

dh) transaksionet, përfshirë negocimin, por jo menaxhimin apo ruajtjen, në aksione kuota, pjesë në shoqëri apo shoqata, në obligacione dhe tituj të tjerë, përveç dokumenteve që vendosin titull mbi mallrat dhe të drejtat apo titujt e përcaktuar në nenin 8, të këtij ligji;

e) menaxhimi i fondeve të investimeve, në kuptim të ligjit për sipërmarrjet e investimeve kolektive;

ë) furnizimi me vlerën e parashtypur i pullave postare për përdorim për shërbime postare në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe pullave të tjera të ngjashme;

f)furnizimi i basteve, lotarive dhe lojërave të tjera të fatit, në kuptim të ligjit për lojërat e fatit;

g) furnizimi i ndërtesave apo i pjesëve të një ndërtese, si edhe furnizimi i tokës, në të cilën qëndron ndërtesa, përveç furnizimit të procesit të ndërtimit;

Në kuptim të kësaj shkronje, me "ndërtesë" kuptohet çdo lloj strukture e fiksuar në tokë;

gj) furnizimi i tokës;

Në kuptim të kësaj shkronje, me "tokë" kuptohet çdo zonë e papunuar, e papërpunuar, e pazhvilluar dhe e pandërtuar e tokës.

h)dhënia me qira e pasurive të paluajtshme, përveç:

i)dhënies me qira të ndërtesave për një periudhë deri në dy muaj;

ii)strehimit në hotele ose vende pushimi, të kryera në sektorin e hotelerisë ose në sektorë që kanë funksione të njëjta, përfshirë qiradhënien e kampeve të pushimit apo të terreneve të pajisura për kampingje;

iii)dhënien me qira të zonave të destinuara për parkimin dhe magazinimin e automjeteve dhe mjeteve të tjera lëvizëse;

iv)dhënien me qira të pajisjeve dhe makinerive të fiksuara në mënyrë të qëndrueshme;

v)dhënien me qira të kasafortave;

i)furnizimi i kartave të identitetit për shtetasit;

j)furnizimi i shërbimeve të shtypshkronjave për gazetat, furnizimi i gazetave, i revistave ~~dhe i librave~~ të çdo lloji, si dhe furnizimi i shërbimit të reklamave nga media e shkruar ~~dhe nga media elektronike~~;

k)furnizimi i shërbimeve të destinuara vetëm për realizimin e fazës së kërkimit të operacioneve hidrokarbure, të kryera nga kontraktorët ose nënkontraktorët, të vërtetuar si të tillë nga Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, lidhur me realizimin e fazës së kërkimit, si dhe furnizimi i mallrave që bëjnë kontraktorët për njëri-tjetrin ose nënkontraktorët për kontraktorët e tyre, të importuara sipas pikës 39, të nenit 56, të këtij ligji.

Ministri i Financave dhe ministri përgjegjës për energjetikën përcaktojnë me udhëzim të përbashkët listën e mallrave dhe shërbimeve, të lidhura me fazën e kërkimit, si dhe procedurën e përjashtimit nga TVSH-ja.

Në kuptim të paragrafit të parë të kësaj shkronje, Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore vërteton se kontraktorët dhe nënkontraktorët, kryejnë furnizime të destinuara vetëm për realizimin e fazës së kërkimit të operacioneve hidrokarbure.

(Ndryshuar me Ligj nr. 96/2018, datë 03.12.2018. Botuar në Fletoren Zyrtare nr.187, datë 28.12.2018)

l) furnizimi i procesit të ndërtimit nga ndërtuesit subjekte të rindërtimit, brenda programit të rindërtimit, të autorizuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve, për rastet e shpalljes së "gjendjes së fatkeqësisë natyrore", përgjatë periudhës së rindërtimit, sipas përcaktimeve të legjislacionit për rindërtimin. Me vendim të Këshillit të Ministrave përcaktohen procedurat për lëshimin e autorizimit, si dhe mënyra e zbatimit të kësaj shkronje;

ll) furnizimi i shërbimeve dhe mallrave i kryer direkt për ndërtuesit subjekte të rindërtimit, brenda programit të rindërtimit, që përdoren prej tyre për procesin e ndërtimit për rastet e shpalljes së "gjendjes së fatkeqësisë natyrore", përgjatë periudhës së rindërtimit, sipas përcaktimeve të legjislacionit për rindërtimin, të autorizuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve. Përjashtimi nga TVSH-ja duhet të reflektohet në çmimin e shitjes së këtyre mallrave dhe shërbimeve, furnizime të cilat duhet të jenë dukshëm me çmime me të ulëta se furnizimet e ngjashme për raste të tjera jo për qëllime të fatkeqësisë natyrore. Asnjë përjashtim nuk akordohet për furnizuesit e mallrave ose shërbimeve që nuk furnizojnë direkt ndërtuesit e autorizuar. Me vendim të Këshillit të Ministrave përcaktohen procedurat për lëshimin e autorizimit, si dhe mënyra e zbatimit të kësaj shkronje.

(Shtuar me Ligj Nr. 85/2019 datë 18.12.2019. Botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 184 datë 31.12.2019)

Neni 54
Të tjera përjashtime nga TVSH-ja

Trajtohen si furnizime të përjashtuara nga TVSH-ja transaksionet e mëposhtme:

a) furnizimet e mallrave që përdoren vetëm për një veprimtari të përjashtuar, sipas neneve 51 dhe 53, të këtij ligji, në rastin kur këto mallra nuk kanë qenë objekt i së drejtës së zbritjes së TVSH-së;

b) furnizimet e mallrave, për të cilat TVSH-ja nuk ishte e zbritshme në blerjen ose përdorimin e tyre, në përputhje me nenin 74, të këtij ligji.

Neni 55
E drejta për të zgjedhur aplikimin e TVSH-së

1. Ministri i Financave, në rrethana e kushte të caktuara, ka të drejtë t'u akordojë personave të tatueshëm të drejtën e zgjedhjes së aplikimit të TVSH-së për secilin prej furnizimeve të përjashtuara, të parashikuara nga shkronjat "b" dhe "e" dhe shkronjat "g", "gj" dhe "h", të nenit 53, të këtij ligji.

2. Këshilli i Ministrave sipas rasteve të furnizimeve të përcaktuara në pikën 1, të këtij neni, për të cilat lejon personat e tatueshëm të ushtrojnë të drejtën e zgjedhjes së TVSH-së, përcakton me vendim modalitetet dhe rregullat e ushtrimit të së drejtës për të ushtruar opsionin, si edhe ka të drejtë të kufizojë shtrirjen e kësaj të drejte.

SEKSIONI 2
PËRJASHTIMI NË IMPORTIME

Neni 56
Përjashtime të veçanta në import

Janë furnizime të përjashtuara nga tatimi mbi vlerën e shtuar në import:

1.Importimi përfundimtar i të gjitha mallrave prej një personi të tatueshëm, furnizimi i të cilave në të gjitha rrethanat brenda vendit do të ishte furnizim i përjashtuar nga tatimi mbi vlerën e shtuar.

2.Importet e dërgesave, mallrave me karakter jotregtar dhe me vlera jo të rëndësishme, në përputhje me vlerën limit të pataksueshme, sipas legjislacionit doganor në fuqi.

3.Importimi i mallrave personale të përdorura, pronë individuale e personave, të cilët ndryshojnë vendqëndrimin e tyre të zakonshëm nga një vend tjetër në Republikën e Shqipërisë, siç përcaktohet në legjislacionin doganor në fuqi. Përjashtimi nuk jepet në lidhje me produktet alkoolike, duhanin apo produktet e duhanit, automjetet dhe pajisjet për kryerjen e një aktiviteti ekonomik, përveç instrumenteve portative të arteve të aplikuara apo të lira.

4.Sende të përfituara nga trashëgimia nga një individ që jeton në Republikën e Shqipërisë, siç përcaktohet në legjislacionin doganor në fuqi.

5.Sende të importuara në raste martese me karakter jotregtar, siç përcaktohet në legjislacionin doganor në fuqi. Asnjë përjashtim nuk jepet për produktet alkoolike, duhanin ose produktet e duhanit.

6.Uniforma, pajisje e sende shkollore dhe sende të tjera me karakter jotregtar, të nevojshme për studime, sipas kërkesave personale, për përdorim nga nxënës e studentë, siç përcaktohet në legjislacionin doganor në fuqi.

7.Mallra që gjenden në bagazhin personal të udhëtarit, me karakter jotregtar dhe të cilat janë të përjashtuara nga pagesa e detyrimet doganore, në përputhje me legjislacionin doganor në fuqi.

8.Pako të vogla mallrash me karakter jotregtar, të dërguara falas nga një individ jashtë Republikës së Shqipërisë për një individ në territorin e Republikës së Shqipërisë, siç përcaktohet në legjislacionin doganor në fuqi.

9.Dekorime dhe shpërblime për tituj nderi nëse natyra e tyre ose vlera individuale tregon se nuk janë importuar për qëllime tregtare.

10.Dhuratat e rastit, të pranuara brenda kuadrit të marrëdhënieve ndërkombëtare, me kusht që të mos jenë me karakter tregtar. Asnjë përjashtim nuk akordohet për produktet alkoolike, duhanin ose për produktet e duhanit.

11.Sendet e destinuara për nevojat e drejtuesve të shteteve të huaja ose përfaqësuesit e tyre gjatë një vizite zyrtare në Republikën e Shqipërisë.

12.Mallrat e importuara, të tilla si karburant dhe vajra lubrifikuese në depozitën e automjetit, të domosdoshme për realizimin e transportit me këtë automjet.

13.Sende të importuara për qëllime funerale, të tilla si arkivole që përmbajnë mbetje të eshtrave, urna dhe zbukurime e pajisje funerali që shoqërojnë ato.

14.Materiale që shërbejnë për ndërtimin, mirëmbajtjen dhe zbukurimin e monumenteve ose varrezave të viktimave të luftës nga vendet tjera.

15.Substancat terapeutike me origjinë njerëzore dhe reagentët për përcaktimin e grupeve të gjakut dhe llojeve indore që shfrytëzohen për qëllime kërkimesh mjekësore apo shkencore, jo me karakter tregtar.

16.Produktet farmaceutike për kujdesin mjekësor ose veterinar, të shfrytëzuara në ngjarjet ndërkombëtare sportive.

17.Kafshë laboratorike, lëndë shtazore, biologjike dhe kimike me destinim për hulumtime shkencore;.

18.Lëndë referuese të miratuara nga Organizata Botërore e Shëndetësisë, me destinacion kontrollin e cilësisë së materialeve të përdorura në prodhimin e produkteve mjekësore, të importuara nga subjektet e autorizuara nga autoriteti kompetent.

19.Mallrat e destinuara për ekzaminime, analiza dhe testime, të cilat shfrytëzohen plotësisht ose shkatërrohen për të përcaktuar përbërjen, cilësinë ose karakteristika të tjera teknike, me qëllime informuese dhe kërkimore tregtare apo industriale. Përjashtimi nuk zbatohet për mallrat e shfrytëzuara në ekzaminimin, analizat ose testimin në funksion të promovimit të shitjeve.

20.Materiale të ndryshme për paketimin dhe ruajtjen e mallrave gjatë transportimit të tyre.

21.Ushqime kafshësh dhe pajisje që nevojiten gjatë transportit të kafshëve.

22.Dokumentacione të ndryshme, siç detajohet në aktet nënligjore në zbatim të Kodit Doganor të Republikës së Shqipërisë.

23.Botime turistike informative me destinim për shpërndarje falas dhe ku qëllimi i tyre kryesor është që të përfaqësojnë produktet dhe shërbimet e huaja turistike.

24.Mallrat dhe materialet e shtypura reklamuese jo për t'u tregtuar ose për t'u përdorur në funksion të veprimtarisë ekonomike, por të destinuara vetëm për shfrytëzim në panair, ekspozitë ose ngjarje të ngjashme, si dhe mostrat e mallrave me vlerë të papërfillshme, të cilat nga pamja dhe sasia nuk janë të shfrytëzueshme për qëllime të ndryshme nga ato që lidhen me nxitjen dhe promovimin e mallrave të të njëjtit lloj. Përjashtimi nuk akordohet për produktet alkoolike, duhanin apo produktet e duhanit dhe karburantet, qofshin këto të ngurta, të lëngshme apo të gazta.

25.Ndihma humanitare të ardhura në adresë e për llogari të organizatave bamirëse humanitare, të institucioneve të kultit, të enteve publike, si dhe të institucioneve shtetërore buxhetore me destinim për shpërndarje falas për ndihmë të personave në nevojë ose për qëllim të shfrytëzimit ekskluzivisht për të plotësuar nevojat e tyre të punës apo për zhvillimin e detyrave të tyre, në funksion të veprimtarisë bamirëse humanitare. Përjashtim nuk akordohet në lidhje me produktet alkoolike, duhanin apo produktet e duhanit, kafen dhe çajin, automjetet motorike, përveç ambulancave.

26.Mjete të posaçme që përdoren për edukimin, trajnimin, punësimin ose për nevoja të personave të verbër dhe të shurdhër ose personave të tjerë me aftësi të kufizuara fizike ose mendore, nëse janë siguruar falas dhe importohen nga institucionet apo organizatat, aktiviteti i të cilave është edukimi dhe asistenca për këta persona, të kryera për qëllime jotregtare nga donatorët.

27.Importimi i mjeteve, të cilat ndihmojnë në integrimin në jetë të invalidëve paraplegjikë dhe tetraplegjikë, përfshirë këtu dhe autovetura të përshtatura për përdorim prej tyre.

28.Mallrat e importuara nga organet dhe organizatat shtetërore, organizatat bamirëse dhe filantropike me destinim për shpërndarje falas për njerëzit e dëmtuar prej fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive të tjera apo nga luftërat. Asnjë përjashtim nuk akordohet për materialet dhe pajisjet e destinuara për rindërtimin e zonave të fatkeqësive, ~~përjashtuar materialet dhe pajisjet e importuara për këtë qëllim nga organe shtetërore për rastet e shpalljes së "gjendjes së fatkeqësisë natyrore" brenda afatit të përcaktuar~~ përjashtuar materialet, pajisjet, ndërtesat e parafabrikuara, të importuara për këtë qëllim nga organe shtetërore, organizatat bamirëse dhe filantropike për rastet e shpalljes së "gjendjes së fatkeqësisë natyrore", brenda programit të rindërtimit. Me vendim të Këshillit të Ministrave përcaktohet mënyra e zbatimit të kësaj dispozite.
(Zëvendësuar me Ligj Nr. 85/2019 datë 18.12.2019. Botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 184 datë 31.12.2019)

29.Sendet dhe dokumentet shoqëruese në funksion të mospërvetësimit apo mbrojtjes së markës tregtare, patentave, të së drejtës së autorit, të destinuara për organizatat për mbrojtjen e të drejtave të pasurisë intelektuale.

30.Furnizimet e bordit të mjeteve të transportit dhe pajisjet e nevojshme për funksionimin normal të tyre.

31.Importimi i kafshëve të gjalla të racës, të dhuruara nga donatorë të ndryshëm.

32.Riimportimet e mallrave në gjendjen, në të cilën ishin eksportuar nga ana e atij që i ka eksportuar, të cilat përfitojnë përjashtim nga taksat doganore.

33.Importimet e mallrave të kryera në kuadrin e marrëdhënieve diplomatike dhe konsullore, të cilat përfitojnë përjashtim nga taksat doganore, mbi bazën e reciprocitetit, si dhe importimet e mallrave të kryera nga organizatat ndërkombëtare, të njohura si të tilla prej autoriteteve publike të Republikës së Shqipërisë, si dhe nga
anëtarët e këtyre organizatave, brenda limiteve dhe sipas kushteve të marrëveshjeve ndërkombëtare, në bazë të cilave janë themeluar.

34.Importimet e mallrave nga forcat e armatosura të shteteve të tjera anëtare të NATO-s për t'u përdorur nga këto forca apo personeli civil që i shoqëron ato si dhe për të furnizuar mensat përkatëse për qëllimin e përbashkët të mbrojtjes.

35.Produktet e peshkimit dhe produkte të tjera në gjendje natyrore, të nxjerra nga ujërat territoriale të një vendi tjetër prej anijeve të regjistruara ose të matrikulluara në Republikën e Shqipërisë që mbajnë flamur shqiptar, si dhe produkte të përftuara në anije - fabrikë nga produktet e përmendura më sipër në këtë pikë, por para se të kryhet ndonjë shitje.

36.Importimet e arit të kryera nga Banka e Shqipërisë.

37.Shërbimet e lidhura me importimet e mallrave, vlera e të cilave është e përfshirë në bazën e tatueshme, në përputhje me shkronjën "b", të pikës 2, të nenit 44, të këtij ligji.

38.Importimi i makinerive dhe pajisjeve:

a)në funksion të realizimit të kontratave të investimeve me vlerë të barabartë ose më të madhe se 50 milionë lekë;

b)në funksion të realizimit të kontratave të investimeve në sektorin e përpunimit aktiv dhe të agrobiznesit, pavarësisht nga vlera e investimit; si dhe

c)importimi i makinerive prodhuese nga subjektet e tatimit të thjeshtuar mbi fitimin. Lista e makinerive dhe pajisjeve që janë direkt të lidhura me investimin, procedura e përjashtimeve, kriteret përkatëse dhe kategoritë e operatorëve ekonomikë, që përfshihen në sektorin e përpunimit aktiv dhe të agrobiznesit, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

39. Importimi i mallrave dhe i shërbimeve, që lidhen me realizimin e fazës së kërkimit të operacioneve hidrokarbure, të kryera nga kontraktorët ose nënkontraktorët që punojnë për këto operacione. Kontraktorët dhe nënkontraktorët vërtetohen si të tillë nga Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore. Ministri i Financave dhe ministri përgjegjës për energjetikën përcaktojnë me udhëzim të përbashkët listën e mallrave dhe shërbimeve të lidhura me fazën e kërkimit, si dhe procedurën e përjashtimit nga TVSH-ja.

40. Importimi i kafshëve të gjalla për majmëri.

~~41. Importimi i makinave bujqësore. Lista e makinave bujqësore, procedura e përjashtimeve dhe kriteret përkatëse përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.~~
Shfuqizohet

42. Importimi i lëndëve të para që përdoren për prodhimin e barnave, me përjashtim të lëndëve me përdorim të dyfishtë, të kryera nga mbajtësit e autorizimit të prodhimit, sipas legjislacionit të fushës për barnat. Lista e lëndëve të para për prodhimin e barnave përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

43. Mallrat dhe pajisjet për qëllime ushtarake dhe që përdoren si armë, municion apo bazë materiale luftarake dhe të cilat janë projektuar, zhvilluar, prodhuar, montuar apo modifikuar për përdorim ushtarak, që importohen në emër të Ministrisë së Mbrojtjes.

44. Importimi i jahteve dhe mjeteve të tjera ujore, që përdoren për qëllime turistike, kënaqësie dhe argëtimi, jo më të vjetra se 20 vjet, që përfshihen në kodin 8903 të Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave.

(Ndryshuar me Ligj nr. 96/2018, datë 03.12.2018. Botuar në Fletoren Zyrtare nr.187, datë 28.12.2018)

(Shtuar me Aktin Normativ nr.4, datë 30.11.2019. Botuar në Fletoren Zyrtare nr.161, datë 30.11.2019, Miratuar me Ligjin Nr. 78/2019, botuar në Fletoren Zyrtare nr.171, datë 16.12.2019)

(Shtuar me Ligj Nr.64/2020, datë 14.05.2020. Botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 118, datë 24.06.2020)

SEKSIONI 3
FURNIZIMET ME SHKALLË ZERO PËR QIND TË TVSH-SË

NËNSEKSIONI 1

EKSPORTET, TRANSPORTI NDËRKOMBËTAR DHE TË TJERA

Neni 57

Eksportet

Trajtohen si furnizime me shkallë zero të TVSH-së transaksionet e mëposhtme të eksportit:

a)furnizimi i mallrave të dërguara ose të transportuara jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë nga shitësi ose për llogari të tij;

b)furnizimi i mallrave të dërguara ose të transportuara jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë nga/ose për llogari të një blerësi që nuk është i vendosur në territorin e Republikës së Shqipërisë;

Ky parashikim nuk zbatohet për mallrat e transportuara nga vetë blerësi për t'u përdorur për pajisjen apo furnizimin e anijeve turistike, mjeteve fluturuese private apo të çdo lloj mjeti tjetër transporti të përdorur për përdorim privat;

c) furnizimi i mallrave organizmave pa qëllim fitimi, të miratuar sipas marrëveshjeve të posaçme që i eksportojnë ato jashtë territorit të republikës së Shqipërisë, si pjesë e veprimtarisë së tyre humanitare, arsimore apo bamirëse jashtë Republikës së Shqipërisë;

Përfitimi i përjashtimit të parashikuar në këtë shkronjë, kryhet sipas një procedure rimbursimi të TVSH-së, modalitetet e aplikimit të së cilës përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Financave;

ç) furnizimi i shërbimeve të përpunimit të mallrave joshqiptare të destinuara për t'u rieksportuar, nga personat e tatueshem të autorizuar dhe nënkontraktorët e tyre, mbi bazën e dispozitave që parashikon Kodi Doganor, për operacione nën regjimin e përpunimit aktiv.

Ministri përgjegjës për financat përcakton me udhëzim dokumentacionin e nevojshëm, për zbatimin e shkronjës "ç"

d) furnizimi i shërbimeve, përfshirë transportin dhe operacionet ndihmëse, përveç shërbimeve që janë të përjashtuara në përputhje me nenet 51 dhe 53, të këtij ligji, në qoftë se janë të lidhura drejtpërdrejt me eksportimet apo importimet e mallrave, sipas nenit 22, të këtij ligji.
(Ndryshuar me Ligj nr. 96/2018, datë 03.12.2018. Botuar në Fletoren Zyrtare nr.187, datë 28.12.2018)

Neni 58
Mallrat në bagazhin personal të udhëtarit

1. Furnizimi i mallrave të destinuara për t'u transportuar në bagazhin personal të udhëtarëve konsiderohet si eksport vetëm në qoftë se përmbushen njëkohësisht kushtet e mëposhtme:

a) udhëtari nuk është i vendosur brenda Republikës së Shqipërisë;

b) mallrat transferohen jashtë Republikës së Shqipërisë, brenda tre muajve që ndjekin muajin e kryerjes së furnizimit;

c) vlera totale e furnizimit e shprehur në lekë ose kundërvlerën e saj në lekë, përfshirë TVSH-në, të mos jetë më e vogël se vlera e përcaktuar me udhëzim të Ministrit te Financave. Kjo vlerë mund të rishikohet jo më shumë se një herë në vit.

2. Për qëllime të pikës 1, të këtij neni, me termin "udhëtar jo të vendosur brenda Republikës së Shqipërisë" kuptohet udhëtari, banesa e përhershme apo rezidenca e zakonshme e të cilit nuk ndodhet brenda Republikës së Shqipërisë. Në këtë rast, me termin "banesë ose rezidencë të zakonshme" kuptohet vendi i treguar si i tillë në pasaportë, në kartën e identitetit ose në një dokument tjetër të pranuar si dokument identifikimi i vlefshëm nga vendi, në territorin e të cilit është kryer furnizimi.

Si dokumenti justifikues i eksportimit në këtë rast shërben fatura tatimore e blerjes, ~~e shoqëruar me kuponin tatimor që vërteton pagesën e kryer~~, të vulosura nga organi doganor në pikën e daljes nga Republika e Shqipërisë.

(Hequr me Ligj Nr. 85/2019 datë 18.12.2019. Botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 184 datë 31.12.2019)

Neni 59
Transporti ndërkombëtar

Janë furnizime me shkallë zero të TVSH-së transaksionet e mëposhtme të transportit ndërkombëtar:

a) furnizimi me karburant dhe me rezerva të tjera të nevojshme të anijeve për lundrimin në det të hapur dhe për transportin ndërkombëtar të pasagjerëve me pagesë ose për ushtrimin e veprimtarive tregtare, industriale e të peshkimit, si edhe të anijeve për kryerjen e veprimeve të shpëtimit dhe ndihmës në det dhe të anijeve për peshkimin bregdetar, përveç furnizimit me rezerva të tjera të nevojshme të anijeve për peshkim bregdetar;

b) furnizimi me karburant dhe me rezerva të tjera të nevojshme të anijeve luftarake të përfshira në kodin e Nomenklaturës së Kombinuar (NC) 8906 10 00, të cilat lënë territorin e Republikës së Shqipërisë me destinacion ose për t'u ankoruar në një port jashtë saj;

c) furnizimi, transformimi, riparimi, mirëmbajtja, qiradhënia dhe qiramarrja e anijeve për lundrim në det të hapur; për transport ndërkombëtar të pasagjerëve me pagesë; për ushtrimin e veprimtarive tregtare, industriale e të peshkimit; për kryerjen e veprimeve të shpëtimit dhe të ndihmës në det; për peshkimin bregdetar; si edhe, furnizimet, qiradhënia, riparimet dhe mirëmbajtja e pajisjeve, përfshirë pajisjet e peshkimit, të trupëzuara ose të përdorura brenda tyre;

ç) furnizimi i shërbimeve, të ndryshme nga ato të parashikuara në shkronjën "c", të këtij neni, të nevojshme për të përmbushur drejtpërdrejt nevojat e anijeve të përmendura në shkronjën "a" dhe të ngarkesës së tyre;

d) furnizimi me karburant dhe me rezerva të tjera të nevojshme të mjeteve fluturuese që përdoren nga kompanitë e transportit ajror për transport ndërkombëtar me pagesë;

dh) furnizimi, transformimi, riparimi, mirëmbajtja, qiradhënia dhe qiramarrja e mjeteve fluturuese që përdoren nga kompanitë e transportit ajror për transport ndërkombëtar me pagesë, si edhe furnizimet, qiradhënia, riparimi dhe mirëmbajtja e pajisjeve, të trupëzuara ose të përdorura, brenda tyre;

e) furnizimi i shërbimeve të ndryshme nga ato të parashikuara në shkronjën "dh", të këtij neni, të nevojshme për të përmbushur drejtpërdrejt nevojat e mjeteve fluturuese, të përmendura në shkronjën "d", të këtij neni, dhe të ngarkesës së tyre;

ë) transporti ndërkombëtar i pasagjerëve nga/ose me destinacion jashtë Republikës së Shqipërisë.

Neni 60
Furnizime të përngjashme me eksportet

1. Trajtohen si furnizime të ngjashme me eksportet:

a)furnizimet e mallrave dhe shërbimet e kryera në kuadrin e marrëdhënieve diplomatike dhe konsullore;

b)furnizimet e mallrave dhe shërbimeve ndaj organizatave ndërkombëtare, si dhe anëtarëve të këtyre organizatave, të njohura si të tilla nga ana e autoriteteve publike të Republikës së Shqipërisë ose nga anëtarët e këtyre organizatave, brenda limiteve dhe sipas kushteve të marrëveshjeve ndërkombëtare, në bazë të të cilave janë themeluar.

2.Furnizimet e mallrave dhe shërbimeve në Republikën e Shqipërisë, të destinuara për forcat e armatosura të shteteve të tjera anëtare të NATO-s për t'u përdorur nga këto forca apo personeli civil që i shoqëron ato, si dhe për të furnizuar mensat përkatëse për qëllimin e përbashkët të mbrojtjes.

3.Ministri i Financave përcakton me udhëzim procedurën specifike ose të rimbursimit të TVSH-së për rastet e mësipërme për të siguruar trajtimin me shkallën tatimore të TVSH-së 0 për qind për këto furnizime që trajtohen si eksporte.

Neni 61

Furnizimi i arit për Bankën e Shqipërisë

1.Trajtohet si furnizim me shkallën e TVSH-së 0 për qind furnizimi i arit ndaj Bankës së Shqipërisë.

2.Ministri i Financave përcakton me udhëzim procedurën specifike ose të rimbursimit të TVSH-së për furnizimin e mësipërm ndaj Bankës së Shqipërisë për të siguruar trajtimin me shkallën tatimore 0 për qind të TVSH-së.

Neni 62
Shërbimi i ndërmjetësit për furnizimet me shkallë 0 për qind të TVSH-së

1. Trajtohen si furnizime me shkallë 0% të TVSH-së furnizimi i shërbimeve nga ndërmjetësit që veprojnë në emër dhe për llogari të një personi tjetër, kur marrin pjesë në transaksionet e përcaktuara në nenet 57, 58, 59, 60 e 61, të këtij ligji, ose në veprimet që kryhen prej tyre jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

2. Parashikimi, sipas pikës 1, të këtij neni, nuk aplikohet për agjentët e udhëtimit, të cilët, duke vepruar në emër dhe për llogari të udhëtarëve, furnizojnë shërbime, të cilat kryhen jashtë Republikës së Shqipërisë.

NËNSEKSIONI 2
PËRJASHTIME PËR TRANSAKSIONE QË LIDHEN ME TREGTINË NDËRKOMBËTARE,MAGAZINAT DOGANORE, MAGAZINAT E TJERA PËRVEÇ ATYRE DOGANORE DHE REGJIME TË NJËJTA

Neni 63
Përkufizime

Për qëllime të këtij seksioni, me termat e mëposhtëm kuptohet:

a)Me termin "Magazina doganore" konsiderohet vendi i përcaktuar si magazinë doganore, sipas legjislacionit doganor në fuqi.

b)Në rastin e produkteve, subjekt i tatimit për akcizën, "Magazina të tjera përveç atyre doganore", konsiderohet vendi i përcaktuar si magazinë fiskale, sipas përcaktimit për magazinat fiskale në ligjin për akcizat në Republikën e Shqipërisë.

Neni 64
Veprime që lidhen me regjimet doganore e të tjera të ngjashme

Trajtohen si furnizime me shkallë zero të TVSH-së veprimet e mëposhtme:

a)furnizimi i mallrave të deklaruara për të qenë nën regjimin e ruajtjes së përkohshme, siç përcaktohet në legjislacionin doganor në fuqi;

b)furnizimi i mallrave të destinuara për t'u vendosur në një zonë të lirë ose në një magazinë të lirë, siç përcaktohet në legjislacionin doganor në fuqi.

c)furnizimi i mallrave, të vendosura nën regjim magazinimi doganor ose nën regjimin e përpunimit aktiv nga mbajtësi i autorizimit dhe nënkontraktorët e tij, siç përcaktohet në legjislacionin doganor në fuqi.

(Ndryshuar me Ligj nr. 96/2018, datë 03.12.2018. Botuar në Fletoren Zyrtare nr.187, datë 28.12.2018)

Neni 65
Furnizimet e mallrave për në det

Trajtohen si furnizime me shkallë zero veprimet e mëposhtme:

a) furnizimet e mallrave që janë të destinuara për t'u pranuar në ujërat territoriale të Republikës së Shqipërisë, në mënyrë që të trupëzohen në platformat e shpimit ose të shfrytëzimit, në funksion të ndërtimit, riparimit, mirëmbajtjes, shndërrimit ose pajisjes së këtyre platformave ose për lidhjen e tyre me tokën;

b) furnizimi me karburant dhe me rezerva të tjera të nevojshme i platformave të shpimit ose të shfrytëzimit, të vendosura në detin territorial të Republikës së Shqipërisë.

Neni 66
Kushte të tjera

1.Furnizimet e parashikuara në nenet 64 dhe 65, të këtij ligji, trajtohen si furnizime me shkallë zero të TVSH- së, me kusht që ato të përdoren për qëllime të veprimtarisë ekonomike, për të cilën janë destinuar, me kusht që të mos jenë për përdorim ose konsumim përfundimtar.

2.Në momentin e çlirimit nga regjimet apo të daljes nga situatat e parashikuara në këtë seksion, llogaritet TVSH-ja për këto mallra, shumë e cila duhet t'i korrespondojë shumës së TVSH-së që do të kërkohej në qoftë se secili prej këtyre operacioneve të kishte qenë subjekt i TVSH-së brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.

Neni 67
Shërbime të lidhura

Furnizimet e shërbimeve që lidhen me furnizimet e mallrave, sipas neneve 64, shkronjat "a", "b", "c", dhe 65, të këtij ligji, trajtohen si furnizime me shkallë zero të TVSH-së.

KREU IX
SEKSIONI 1
LINDJA DHE APLIKIMI I SË DREJTËS SË ZBRITJES

Neni 68
Lindja e së drejtës së zbritjes
Parim i përgjithshëm

E drejta e zbritjes lind kur TVSH-ja e zbritshme bëhet e kërkueshme.

Neni 69
Zbritja e TVSH-së

1. Personi i tatueshëm gëzon të drejtën që të zbresë nga TVSH-ja e llogaritur për transaksionet e tatueshme shumat e mëposhtme të TVSH-së, në masën që furnizimet e mallrave dhe shërbimeve të marra përdoren nga personi i tatueshëm në funksion të këtyre transaksioneve të tatueshme:

a)TVSH-në e paguar apo për t'u paguar në Republikën e Shqipërisë për furnizimet e mallrave dhe shërbimeve që i janë furnizuar ose do t'i furnizohen këtij nga ana e një tjetër personi të tatueshëm;

b)TVSH-në për t'u paguar për veprimet e përngjashme me shitjet e mallrave dhe me kryerjen e shërbimeve, në përputhje me shkronjat "c" dhe "ç", të pikës 2, të nenit 9, dhe të shkronjës "c", të pikës 2, të nenit 12, të këtij ligji.

c) TVSH-në e paguar për mallrat e importuara në Shqipëri.

2.Për pasurinë e paluajtshme, e cila bën pjesë në pasurinë e biznesit të personit të tatueshëm dhe që përdoret njëkohësisht si për qëllime të veprimtarisë së tij ekonomike, edhe për qëllime të tjera të ndryshme nga ato të veprimtarisë ekonomike, TVSH-ja mbi furnizimet e marra, të lidhura direkt me këtë pasuri është e zbritshme në proporcion me përdorimin e kësaj pasurie për qëllime të veprimtarisë ekonomike të personit të tatueshëm.

3.TVSH-ja e furnizimeve të marra të mallrave të tjera, të ndryshme nga ato në pikën 2, të këtij neni, dhe që janë pjesë e pasurisë së biznesit, është e zbritshme në proporcion me përdorimin e kësaj pasurie për qëllime të veprimtarisë ekonomike të personit të tatueshëm.

Neni 70
Të tjera për zbritjen

Personi i tatueshëm ka të drejtën gjithashtu të zbritjes së shumave të TVSH-së, të parashikuara në nenin 69, të këtij ligji, në masën që ato mallra dhe shërbime janë përdorur për nevoja të transaksioneve të mëposhtme:

a) furnizimet në kuadër të veprimtarisë ekonomike të personit të tatueshëm, të kryera jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, të cilat në qoftë se do të kryheshin brenda vendit do t'i jepnin të drejtën e zbritjes së TVSH-së personit të tatueshëm.

b) furnizimet e personit të tatueshëm, sipas pikës 37, të nenit 56, dhe furnizimet me shkallë zero të TVSH-se sipas neneve 57, 58, 59, 60, 61, 62, dhe 64, 65 dhe 67, të këtij ligji.

c) furnizimet e personit të tatueshëm, të përjashtuara nga TVSH-ja, në përputhje me nenin 53, shkronjat nga "a" deri në "dh", kur personi i tatueshëm, të cilit i destinohen shërbimet është i vendosur jashtë Republikës së Shqipërisë ose kur transaksione të tilla janë drejtpërdrejt të lidhura me mallra të destinuara për t'u eksportuar jashtë Republikës së Shqipërisë.

SEKSIONI 2
ZBRITJA E PJESSHME E TVSH-SË

Neni 71
Rregulli i përgjithshëm

Nëse furnizimet e mallrave dhe shërbimeve përdoren nga një person i tatueshëm, si për kryerjen e transaksioneve të tatueshme që sjellin të drejtën e zbritjes së TVSH-së, mbi bazën e neneve 69 dhe 70, të këtij ligji, edhe për transaksionet që nuk e sjellin këtë të drejtë, atëherë vetëm pjesa e TVSH-së që lidhet me kategorinë e parë të transaksioneve është e zbritshme.

Pjesa e TVSH-së së zbritshme përcaktohet mbi bazën e neneve 72 e 73 për tërësinë e transaksioneve të kryera nga ana e personit të tatueshëm.

Neni 72
Llogaritja e koeficientit të zbritjes së TVSH-së

1. Koeficienti i zbritjes së TVSH-së llogaritet nga raporti i mëposhtëm:

a) në numërues, shumën totale të vëllimit të xhiros vjetore, pa TVSH-në, lidhur me transaksionet që sjellin të drejtën e zbritjes, sipas neneve 69 dhe 70, të këtij ligji.

b) në emërues, shumën totale të vëllimit të xhiros vjetore, pa TVSH-në, lidhur me transaksionet e përfshira në numërues dhe me transaksionet që nuk sjellin të drejtën e zbritjes.

2. Në ndryshim nga pika 1, e këtij neni, për llogaritjen e koeficientit të zbritjes së TVSH-së, nuk merren parasysh shumat e mëposhtme:

a) vlera e qarkullimit të realizuar nga furnizimet e mallrave kapitale, të përdorura nga personi i tatueshëm për nevoja të biznesit së tij;

b) vlera e qarkullimit, të realizuar nga transaksione financiare dhe të pasurive të paluajtshme nëse këto transaksione janë rastësore;

c) vlera e qarkullimit, të realizuar nga transaksione të përcaktuara nga shkronja “b” deri në “e”, të nenit 53, të këtij ligji, nëse këto transaksione janë rastësore.

Neni 73
Rregullat për aplikimin e koeficientit të zbritjes së TVSH-së

1. Koeficienti i zbritjes së TVSH-së përcaktohet mbi bazë vjetore, përcaktohet në përqindje dhe rrumbullakoset në maksimum me njësinë më të lartë.

2. Koeficienti i zbritjes së TVSH-së, e aplikueshme provizorisht për një vit, është koeficienti fillestar i zbritjes dhe ky koeficient llogaritet mbi bazën e transaksioneve të vitit të mëparshëm në kushtet e nenit 71, të këtij ligji. Në mungesë të këtyre transaksioneve ose kur shuma e tyre është e papërfillshme, koeficienti fillestar i zbritjes së TVSH-së vlerësohet provizorisht prej vetë personit të tatueshëm, në bazë të parashikimeve të tij dhe nën mbikëqyrjen e administratës tatimore.

3. Zbritja e TVSH-së, e kryer mbi bazën e koeficientit fillestar të zbritjes, duhet të rregullohet në periudhën e parë tatimore të vitit pasardhës, sipas koeficientit përfundimtar të zbritjes së TVSH-së.

4. Për qëllime të këtij neni, personi i tatueshëm duhet të njoftojë administratën tatimore për koeficientin fillestar të zbritjes së TVSH-së që do të aplikojë gjatë vitit dhe për mënyrën e llogaritjes së saj, jo më vonë se:

a) data 31 janar, në rastin kur nuk është viti i parë i aplikimit të koeficientit të zbritjes së TVSH-së.

Në këtë rast koeficienti fillestar i zbritjes së TVSH-së është koeficienti përfundimtar i zbritjes së TVSH-së për vitin paraardhës;

b) afati i deklarimit të periudhës së parë tatimore, në të cilën lind detyrimi për të aplikuar koeficientin fillestar të zbritjes së TVSH-së.

5. Ministri i Financave përcakton me udhëzim rregullat dhe modalitetet e aplikimit të këtij neni.

SEKSIONI 3
KRITERET DHE KUFIZIMET E SË DREJTËS SË ZBRITJES

Neni 74
Kufizimet e së drejtës së zbritjes

1. Përjashtohen nga e drejta e zbritjes së TVSH-së shpenzimet për blerjen, importin e mallrave, shpenzimet për shërbimet si më poshtë:

a) shpenzimet e karburantit, përveç rastit kur:

i)qëllimi i veprimtarisë ekonomike është blerja e karburantit me qëllim për ta shitur atë;

ii)karburanti i blerë është përdorur për nevoja teknologjike në funksion të arritjes së qëllimit primar të biznesit. Në këtë rast, me kushtin që karburanti i blerë të përdoret vetëm për nevoja të veprimtarisë ekonomike të tatueshme dhe për asnjë nevojë tjetër, TVSH-ja kreditohet deri në normativat e përcaktuara në udhëzimin e Ministrit të Financave sipas veprimtarive;

b) shpenzimet e karburantit të çdo lloji, i përdorur për autoveturat;

c) shpenzimet për autovetura dhe shërbimet në lidhje me to, përveç rasteve kur: i)qëllimi i veprimtarisë ekonomike është blerja e autoveturave vetëm me qëllim për t'i shitur ato;

ii)përdorimi i autoveturave është i vetmi qëllim i veprimtarisë ekonomike (dhënia me qira, shërbimi i taksive, ambulancave dhe veprimtari të ngjashme të kësaj natyre);

ç) shpenzimet për udhëtime e dieta, strehimin në hotele, veprimtari çlodhëse dhe argëtuese, shpenzime luksi dhe të përfaqësimit gjatë ushtrimit të veprimtarisë ekonomike. Për shpenzimet e përfaqësimit e drejta e zbritjes nuk lejohet për
shpenzime përtej normës së lejuar për njohjen e tyre si shpenzim i zbritshëm, në përputhje me ligjin që trajton tatimin mbi fitimin.

2. Këshilli i Ministrave përcakton moslejimin e ushtrimit të së drejtës së zbritjes së TVSH-së së paguar ose për t'u paguar për mallra apo shërbime të përdoruara për nevoja të transaksioneve të parashikuara në nenin 70, shkronjat "a" dhe "c", të këtij ligji.

Neni 75
Kriteret për ushtrimin e së drejtës së zbritjes së TVSH-së

Që të mund të ushtrojë të drejtën e zbritjes së TVSH- së, personi i tatueshëm duhet të përmbushë kriteret e mëposhtme:

a) për zbritjen, sipas përcaktimit të shkronjës "a", të pikës 1, të nenit 69, të këtij ligji, lidhur me shitjet e mallrave dhe kryerjen e shërbimeve, të zotërojë një faturë të hartuar në përputhje me nenet nga 96 deri në 105, të këtij ligji;

b) për zbritjen, sipas përcaktimit të shkronjës "b", të pikës 1, të nenit 69, të këtij ligji, lidhur me veprimet e përngjashme me shitjet e mallrave dhe me kryerjen e shërbimeve, duhet të përmbushen formalitetet e përcaktuara me udhëzim nga Ministri i Financave;

c)për zbritjen e TVSH-së, sipas përcaktimit të shkronjës "c", të pikës 1, të nenit 69, të këtij ligji, lidhur me importimet e mallrave, personi i tatueshëm duhet të zotërojë një dokument që provon importimin, të lëshuar në momentin e çlirimit për qarkullim të lirë të mallrave në territorin e Republikës së Shqipërisë, siç përcaktohet në Kodin Doganor të Republikës së Shqipërisë, në të cilin ai cilësohet si marrësi ose importuesi i mallit dhe ku të shkruhet shuma e TVSH-së së paguar dhe mënyra e llogaritjes së saj;

ç) kur blerësi detyrohet të paguajë TVSH-në, sipas përcaktimit të pikës 2, të nenit 86, të këtij ligji, duhet të përmbushen formalitetet përkatëse, të përcaktuara me udhëzim nga Ministri i Financave.

Neni 76
Mënyra e ushtrimit të së drejtës së zbritjes

1. Personi i tatueshëm e kryen zbritjen që ushtrohet, sipas përcaktimit të nenit 75, të këtij ligji, duke zbritur nga shuma e TVSH-së së llogaritur mbi vlerën totale të tatueshme të të gjitha furnizimeve të tatueshme të kryera gjatë një periudhe tatimore shumën e TVSH-së, për të cilën ka lindur e drejta e zbritjes, gjatë së njëjtës periudhë tatimore.

2. Në qoftë se për një periudhë tatimore vlera e TVSH- së së zbritshme e kalon atë të TVSH-së së llogaritur për t'u paguar, atëherë teprica e TVSH-së mbartet për t'u zbritur në periudhën pasardhëse.

3. Teprica e TVSH-së, e mbartur për t'u zbritur në periudhën pasardhëse, rimbursohet sipas kritereve të përcaktuara në nenin 77, të këtij ligji.

4. Nëse personi i tatueshëm nuk kryen zbritjen e TVSH-së në periudhën tatimore në të cilën i lind e drejta e zbritjes, ai mund ta zbresë këtë shumë të TVSH-së së zbritshme pas kësaj periudhe tatimore, por jo më vonë se 12 periudha tatimore përfshirë periudhën në fjalë.

5. Nëse personi i tatueshëm pranon një faturë që tregon TVSH-në nga personi, i cili nuk ka të drejtë të llogaritë TVSH-në, sipas këtij ligji, personi, i cili pranon faturën, pavarësisht se e

ka paguar, nuk duhet të zbresë TVSH-në e paraqitur në faturë, ndërkohë që personi që e ka llogaritur padrejtësisht duhet t'ia paguajë TVSH-në administratës tatimore.

Personi i tatueshëm, i cili ka pranuar një faturë, sipas kushteve të pikës 4, të nenit 86, të këtij ligji, nuk ka të drejtë të zbresë TVSH-në e shënuar në faturë.

6.Nëse një person i tatueshëm pranon një faturë që tregon një shumë të TVSH-së, e cila e tejkalon shumën e TVSH-së që duhej të ngarkohej sipas këtij ligji, personi i tatueshëm që pranon faturën, pavarësisht nëse e ka paguar, nuk duhet të zbresë shumën e TVSH-së të llogaritur më tepër.

7.Personi i tatueshëm, për të cilin është kryer një furnizim malli ose shërbimi në kushtet e pikës 7, të nenit 86, të këtij ligji, nuk ka të drejtë të zbresë TVSH-në e shënuar në faturë.

SEKSIONI 4
RIMBURSIMI

Neni 77
Rimbursimi i TVSH-së

1. Një person i tatueshëm kërkon rimbursim të tepricës së kreditimit tatimor të TVSH-se nëse:

a) personi i tatueshëm ka mbartur tepricën e TVSH-së së zbritshme për 3 muaj radhazi, sipas pikave 2 dhe 3, të nenit 76, të këtij ligji; dhe

b) TVSH-ja e kërkuar për t'u rimbursuar tejkalon shumën prej 400 000 (katërqind mijë) lekësh.

2. Për rastet kur në marrëveshjet financiare të ratifikuara nga Kuvendi ose në marrëveshjet e granteve të miratuara nga Këshilli i Ministrave parashikohet mospërdorimi i burimeve financiare të huaja për të paguar taksa e tatime, duke përfshirë ose jo tatimin mbi vlerën e shtuar, tatimi mbi vlerën e shtuar i paguar u rimbursohet financuesve të huaj nga sistemi ~~i~~ thesarit, brenda 30 ditëve, sipas rregullave të caktuara nga Ministri i Financave. ~~Tatimi mbi vlerën e shtuar për importimin e materialeve ushtarake për Forcat e Armatosura, të dhuruara nga vendet anëtare të Aleancës së NATO-s apo partnerët, paguhet si kosto lokale nga Ministria e Mbrojtjes.~~

3. Eksportuesit kanë të drejtë të kërkojnë rimbursim kur teprica e tyre tejkalon shumën 400 000 (katërqind mijë) lekë. Këshilli i Ministrave përcakton kategorinë e eksportuesve, sipas këtij neni.

4. Brenda 60 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës së tatimpaguesit dhe brenda 30 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës së tatimpaguesve eksportues, drejtoria rajonale e tatimeve verifikon situatën tatimore të tatimpaguesit, ushtron kontroll bazuar në analizën e riskut dhe miraton tepricën kreditore si të rimbursueshme. Pagesa e tepricës kreditore të rimbursueshme kryhet brenda 5 ditëve nga miratimi, nëpërmjet sistemit të thesarit. Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve, për shkaqe të arsyeshme, me kërkesë të drejtorit të drejtorisë rajonale tatimore, ka të drejtë të shtyjë afatin e kontrollit dhe miratimit të tepricës kreditore për një tatimpagues deri në 60 ditë. Administrata tatimore, para se të procedojë një kërkesë për

rimbursim të TVSH-së për një person të tatueshëm, ka të drejtë ta detyrojë atë person të provojë që qëllimi i veprimtarisë ekonomike është realizimi i transaksioneve të tatueshme, që i japin të drejtën e zbritjes së TVSH-së.

5. Ministri i Financave përcakton me udhëzim mënyrën e zbatimit të dispozitave të këtij neni.

(Shfuqizuar me Aktin Normativ nr.4, datë 30.11.2019. Botuar në Fletoren Zyrtare nr.161, datë 30.11.2019, Miratuar me Ligjin Nr. 78/2019, botuar në Fletoren Zyrtare nr.171, datë 16.12.2019)

SEKSIONI 5
RREGULLIMI I ZBRITJES SË APLIKUAR TË TVSH-SË

Neni 78
Rregulli i përgjithshëm

Zbritja e TVSH-së e kryer më parë rregullohet kur është më e lartë apo më e ulët se ajo vlerë për të cilën personi i tatueshëm ka gëzuar të drejtën e zbritjes.

Neni 79
Rregullat për zbatimin e rregullimit të zbritjes

1. Rregullimi i zbritjes së TVSH-së kryhet, veçanërisht, kur, pas deklarimit të TVSH-së, kanë ndryshuar faktorët e marrë në konsideratë për përcaktimin e shumës së TVSH- së së zbritur, si për shembull, në rast se blerjet janë anuluar ose janë përfituar reduktime çmimi.
2. Si përjashtim nga dispozita e pikës 1, të këtij neni, rregullimi i zbritjes së TVSH-së nuk kryhet në rastin e transaksioneve të papaguara tërësisht apo pjesërisht ose në raste shkatërrimi, humbjeje apo vjedhjeje të pasurisë, të provuara apo të konfirmuara sipas procedurave përkatëse ligjore, si edhe në rastin e mallrave të rezervuara për qëllime dhuratash me vlerë të vogël ose për t'u përdorur si mostra apo kampione, sipas përcaktimit të pikës 3, të nenit 9, të këtij ligji.
3. Ministri i Financave përcakton me udhëzim rastet kur në ndryshim nga pika 2, e këtij neni, për transaksione të papaguara tërësisht ose pjesërisht dhe në rastet e një vjedhjeje të pasurisë, pavarësisht nëse janë të provuara apo të konfirmuara, sipas procedurave përkatëse ligjore, kryhet rregullimi i zbritjes së TVSH-së.
4. Ministri i Financave përcakton me udhëzim mënyrën e zbatimit të dispozitave të këtij neni.

Neni 80
Kriteret e rregullimit të zbritjes së TVSH-së për mallrat kapitale

1. Rregullimi i zbritjes së TVSH-së për mallrat kapitale të luajtshme dhe të paluajtshme kryhet kur ndryshimet e së drejtës së zbritjes së TVSH-së ndodhin përgjatë viteve pasuese, siç përcaktohet në pikat 3 dhe 4, të këtij neni, kundrejt vitit në të cilin mallrat janë blerë apo prodhuar.

2. Ndryshimet e së drejtës së zbritjes përgjatë afateve të përcaktuara në pikat 3 dhe 4, të këtij neni, ndodhin kur mallrat ndryshojnë destinacion, duke kaluar nga një

veprimtari e tatueshme, që gëzon të drejtën e zbritjes së TVSH-së, në një veprimtari që nuk jep të drejtën e zbritjes së saj dhe anasjelltas.

3. Rregullimi i zbritjes së TVSH-së për mallrat kapitale të luajtshme shtrihet përgjatë një periudhe të plotë prej 5 vitesh, duke filluar nga data, në të cilën mallrat janë blerë apo prodhuar.

Rregullimi vjetor i zbritjes së TVSH-së për mallrat kapitale të luajtshme kryhet për një të pestën e TVSH-së që ka rënduar mbi vlerën e mallit ose, kur periudha e rregullimit është zgjatur, rregullimi i zbritjes së TVSH-së kryhet për pjesën përkatëse që i takon kësaj periudhe.

4.Rregullimi i zbritjes së TVSH-së për mallrat kapitale të paluajtshme shtrihet përgjatë një periudhe të plotë prej 10 vitesh, duke filluar nga data, në të cilën mallrat janë blerë apo prodhuar.

Rregullimi vjetor i zbritjes së TVSH-së për mallrat kapitale të paluajtshme kryhet për një të dhjetën e TVSH-së që ka rënduar mbi vlerën e mallit ose, kur periudha, për të cilën do të kryhet rregullimi, është më e gjatë se një vit, rregullimi bëhet me pjesën e së dhjetës që mbetet para përfundimit të afatit 10-vjeçar.

Neni 81
Furnizimi gjatë periudhës së rregullimit

1. Në rast se mallrat kapitale furnizohen gjatë periudhës së rregullimit ato konsiderohen si të ishin përdorur për një veprimtari ekonomike të personit të tatueshëm deri në fund të periudhës së rregullimit. Aktiviteti ekonomik i personit të tatueshëm konsiderohet:

a)tërësisht i tatueshëm kur furnizimi i mallrave kapitale I nënshtrohet TVSH-së;

b)tërësisht i përjashtuar nga tatimi kur furnizimi i mallrave kapitale është i përjashtuar nga TVSH-ja.

2. Rregullimi i zbritjes së TVSH-së, i parashikuar në pikën 1, të këtij neni, kryhet vetëm një herë për të gjithë kohën e mbetur të periudhës së rregullimit.

Neni 82
Të tjera për rregullimin e zbritjes së TVSH-së

1.Në kuptim të këtij kreu, termi “mallra kapitale” nënkupton çdo aktiv material afatgjatë që personi i tatueshëm përdor gjatë një procesi prodhimi për të prodhuar mallra ose shërbime konsumi, si për shembull, ndërtesat, pajisjet, makineritë.

2.Ministri i Financave me udhëzim përcakton rregullat praktike për zbatimin e dispozitave që kanë të bëjnë me rregullimin e zbritjes së TVSH-së, si dhe për marrjen e të gjitha masave të nevojshme që rregullimi i zbritjes të mos sjellë ndonjë avantazh të pajustifikuar, si dhe për të krijuar lehtësi për administrimin.

3.Përveç sa është parashikuar në pikën 1, të këtij neni, Ministri i Financave mund të konsiderojë si mallra kapitale, për qëllime të zbatimit të rregullimit të së drejtës së zbritjes së TVSH-së, shërbimet që kanë karakteristika të njëjta me ato të mallrave kapitale.

Neni 83

E drejta e zbritjes në lidhje me regjimin e ushtruar

Në rastin kur personi i tatueshëm kalon nga regjimi i përgjithshëm në një regjim të veçantë ose anasjelltas, për TVSH-në, Ministri i Financave mund të marrë masat e nevojshme dhe të përcaktojë kriteret dhe procedurat në lidhje me të drejtën e zbritjes së TVSH-së, për të shmangur privilegjimin apo diskriminimin në mënyrë të pajustifikueshme të personit të tatueshëm.

Neni 84
Borxhi i keq

1. Kur një pagesë nuk është marrë plotësisht apo pjesërisht për një furnizim të tatueshëm prej furnizuesit dhe është shpallur si i pambledhshëm nga organet gjyqësore, lejohet zbritja e TVSH-së përkatëse, e cila është TVSH e zbatuar në përputhje me këtë ligj për shumën e paarkëtuar të borxhit të keq.

2. Zbritja e TVSH-së lejohet në çdo periudhë tatimore pasi borxhi bëhet borxh i keq dhe fillon, të paktën, gjashtë muaj pas mbylljes së periudhës tatimore, për të cilën TVSH-ja ishte zbatuar në lidhje me furnizimin.

3. Personi i tatueshëm duhet të lëshojë një faturë për shumën e paarkëtuar ku të shkruhen fjalët "Borxh i keq" si dhe numri i faturës, me të cilën lidhet ky borxh, faturë, e cila i shërben shitësit për të zvogëluar detyrimin për TVSH-në dhe blerësit për të zvogëluar TVSH-në e zbritshme.

4. Kur zbritja e TVSH-së për borxhin e keq është kryer siç parashikohet në ketë nen dhe ky borxh paguhet më vonë plotësisht apo pjesërisht, shuma e arkëtuar trajtohet si një furnizim i ri dhe në faturën e lëshuar për këtë furnizim cilësohet numri i faturës së borxhit të keq si dhe shkruhet shprehja "Borxh i keq i paguar".

KREU X
DETYRIMET E PERSONAVE TË TATUESHËM DHE TË DISA PERSONAVE JO TË TATUESHËM

SEKSIONI 1
DETYRIMET E PAGESËS SË TVSH-SË DHE PERSONAT PËRGJEGJËS

Neni 85
Koncepti i personit të tatueshëm në lidhje me vendndodhjen

Për qëllime të këtij seksioni, një person i tatueshëm, që ka një vendndodhje fikse në Republikën e Shqipërisë, kryen një furnizim të tatueshëm mallrash ose shërbimesh në Republikën e Shqipërisë, vend ku lind detyrimi për të paguar TVSH-në, dhe vendndodhja fikse që ka në

Republikën e Shqipërisë nuk merr pjesë në kryerjen e këtij furnizimi, konsiderohet si një person i tatueshëm që nuk është i vendosur në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Neni 86
Personi përgjegjës për pagesën e TVSH-së

1.TVSH-ja paguhet nga ana e personit të tatueshëm që kryen një furnizim mallrash ose shërbimesh të tatueshëm, përveç rasteve kur përcaktohet ndryshe.

2.TVSH-ja është e pagueshme nga personi i tatueshëm ose personi juridik i patatueshëm, i identifikuar për TVSH- në, të cilit i janë furnizuar shërbimet, siç përcaktohet në pikën 1, të nenit 24, të këtij ligji, nëse këto shërbime furnizohen nga një person i tatueshëm që nuk është i vendosur në territorin e Republikën e Shqipërisë. Ministri i Financave përcakton me udhëzim procedurat për zbatimin e kësaj pike.

3.TVSH-ja paguhet nga çdo person, i cili e shënon TVSH-në në një faturë.

4.Kur fatura e lëshuar nuk përkon me furnizimin e mallit apo me kryerjen e shërbimit ose tregon një çmim që nuk duhet të paguhet efektivisht nga blerësi, TVSH-ja paguhet nga personi që e ka faturuar atë.

5.Në import TVSH-ja paguhet nga personi ose personat përgjegjës për pagesën e detyrimeve doganore në import, siç përcaktohet në Kodin Doganor të Republikës së Shqipërisë.

6.TVSH-ja paguhet nga personi, i cili çliron mallrat për qarkullim të lirë nga regjimet e përcaktuara në nenet 64 dhe 65, të këtij ligji.

7.Personi i tatueshëm, për të cilin është kryer një furnizim malli ose shërbimi dhe që ka dijeni ose nuk mund të mohojë faktin që TVSH-ja për t'u paguar ose pjesë e kësaj TVSH-je mbi këtë furnizim ose mbi të gjitha furnizimet e mëparshme të mallrave a shërbimeve, nuk është paguar për shkak të mashtrimit, është përgjegjës bashkë me furnizuesin për pagesën e TVSH-së.

8.Parashikimi i bërë në pikën 7, të këtij neni, dhe në pikën 7, të nenit 76, të këtij ligji, nuk zbatohen njëkohësisht për të njëjtin furnizim.

Neni 87
Përfaqësuesi tatimor

Në rastet që i referohen pikës 1, të nenit 86, të këtij ligji, kur personi përgjegjës për pagesën e TVSH-së është një person i tatueshëm që nuk është i vendosur në Republikën e Shqipërisë, vend në të cilin duhet të paguhet TVSH-ja, në zbatim të këtij neni, ky person duhet të caktojë një përfaqësues tatimor në Republikën e Shqipërisë si person përgjegjës për pagesën e TVSH-së, përveç kur personi, të cilit i janë furnizuar mallrat ose shërbimet, është një person i tatueshëm, i regjistruar në Republikën e Shqipërisë dhe i nënshtrohet pikës 2, të nenit 86, të këtij ligji.

Neni 88
Rregullat e përfaqësuesit tatimor

1. Një person caktohet si përfaqësues tatimor i personit që nuk është i vendosur në Republikën e Shqipërisë vetëm në qoftë se ai ka një vend të veprimtarisë ekonomike në Republikën e Shqipërisë.

2. Një person i emëruar si përfaqësues tatimor është personalisht përgjegjës, në bazë të këtij ligji, për të përmbushur të gjitha detyrimet, përfshirë çdo gjobë a dënim, për të cilat detyrohet personi i përfaqësuar dhe gëzon të gjitha të drejtat e personit të përfaqësuar sipas këtij ligji.

3.Nëse, në kundërshtim me pikën 1, të këtij neni, personi që nuk është i vendosur në Republikën e Shqipërisë, i cili është përgjegjës për pagesën e TVSH-së, nuk emëron një përfaqësues tatimor, të gjitha detyrimet dhe penalitetet në ngarkim të tij do të paguhen nga përfituesi vendas i furnizimit.

SEKSIONI 2
RREGULLAT E PAGIMIT TË TVSH-SË

Neni 89
Pagesa e TVSH-së

Çdo person i tatueshëm, i cili është pagues i TVSH-së, duhet të paguajë shumën e TVSH-së së pagueshme jo më vonë se data e paraqitjes së deklaratës së TVSH-së, të hartuar në përputhje me nenin 106, të këtij ligji.

Neni 90
Pagesa e TVSH-së në importin e mallrave

Pagesa e TVSH-së për importimet e mallrave bëhet siç përcaktohet në Kodin Doganor të Republikës së Shqipërisë për pagesën e detyrimeve doganore në import.

SEKSIONI 3
IDENTIFIKIMI

Neni 91
Regjistrimi i personit të tatueshëm

1.Çdo person i tatueshëm duhet të deklarojë fillimin e veprimtarisë së tij ekonomike dhe të regjistrohet si i tillë brenda 15 ditëve nga data e fillimit të kësaj veprimtarie.

2.Duhet të regjistrohet gjithashtu, nëpërmjet përfaqësuesit tatimor çdo person i tatueshëm, i cili nuk është i vendosur në Republikën e Shqipërisë, por kryen furnizime shërbimesh, për të cilat TVSH-ja paguhet në Republikën e Shqipërisë, sipas neneve 87 dhe 88, të këtij ligji, të ndryshme nga ato, për të cilat TVSH-ja kërkohet të paguhet nga personi i tatueshëm, marrës i shërbimit në Shqipëri.

3.Personat e parashikuar në pikat 1 dhe 2, të këtij neni, për t'u identifikuar dhe regjistruar, veprojnë në përputhje me ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit dhe ligjin për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë.

4. Administrata tatimore, sipas procedurave të përcaktuara në ligjin për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë, ka të drejtë të regjistrojë një person edhe në qoftë se ai nuk ka kërkuar të regjistrohet, kur konstaton që personi ka plotësuar kushtet për të qenë person i tatueshëm, në kuptim të këtij ligji.

Neni 92
Numri i identifikimit

Çdo person i tatueshëm identifikohet me anën e një numri identifikimi për TVSH-në. Numri i identifikimit të personit të tatueshëm është individual dhe shënohet në certifikatën e lëshuar për këtë qëllim, në përputhje me ligjin për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë.

Administrata tatimore, për qëllime të këtij ligji, për të identifikuar çdo person të tatueshëm, krijon dhe mban një regjistër të veçantë, i cili është pjesë e regjistrit të përgjithshëm, siç përcaktohet në ligjin për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë.

Neni 93
Çregjistrimi

Personi i tatueshëm, i regjistruar në përputhje me dispozitat e këtij kreu, detyrohet të kërkojë çregjistrimin jo më vonë se 15 ditë nga dita e fundit kur ai ka kryer furnizime të tatueshme, si pjesë të veprimtarisë së tij ekonomike.

Çregjistrimi i personit të tatueshëm kryhet në përputhje me procedurën e parashikuar në ligjin për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë.

Neni 94
Detyrimi për të njoftuar ndryshimet

Personi i tatueshëm, i regjistruar në përputhje me dispozitat e këtij kreu, detyrohet të njoftojë administratën tatimore, me shkrim, brenda 15 ditëve për çdo ndryshim në emrin, adresën, veprimtarinë e tij ekonomike ose për çdo ndryshim në informacionin e dhënë prej tij organeve tatimore në kohën kur ka kërkuar të identifikohet për TVSH-në.

Njoftimi i ndryshimeve të personit të tatueshëm kryhet në përputhje me procedurën e parashikuar në ligjin për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë.

SEKSIONI 4
FATURIMI

Neni 95

Përkufizime

Për qëllime të këtij seksioni, me:

a)"Faturë" kuptohet çdo dokument në letër ose në formë elektronike që përmbush kushtet e përcaktuara në këtë ligj.

b)"Faturë elektronike" kuptohet një faturë që përmban informacionin e kërkuar në këtë ligj, e cila është lëshuar dhe është marrë ~~në një format elektronik~~ në formatin elektronik, sipas legjislacionit në fuqi për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit.

(Zëvendësuar me Ligj Nr. 85/2019 datë 18.12.2019. Botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 184 datë 31.12.2019)

c)Në kuptim të këtij neni, trajtohet si faturë çdo dokument në letër ose formë elektronike që ndryshon dhe i referohet në mënyrë specifike dhe të qartë faturës fillestare dhe që, për qëllime të këtij ligji, janë dokumentet e emërtuara si më poshtë:

i)notë krediti, dokument i lëshuar nga personi i tatueshëm për pranuesin e mallrave ose shërbimeve, për qëllim të një rregullimi në rritje të detyrimit të TVSH-së, pasi të jetë lëshuar fatura tatimore për atë furnizim të tatueshëm.

ii)notë debiti, dokument i lëshuar nga personi i tatueshëm për pranuesin e mallrave ose shërbimeve, për qëllim të një rregullimi në zbritje të detyrimit të TVSH-së, pasi të jetë lëshuar fatura tatimore për atë furnizim të tatueshëm.

Neni 96
Parimi i përgjithshëm mbi faturimin

1.Faturimi kryhet sipas rregullave të përcaktuara në këtë seksion dhe në legjislacionin në fuqi për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit për të gjitha furnizimet e mallrave dhe të shërbimeve, vendi i të cilave, sipas dispozitave të kreut IV, të këtij ligji, është në Republikën e Shqipërisë.

(Ndryshuar me Ligj Nr. 85/2019 datë 18.12.2019. Botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 184 datë 31.12.2019)

2.Faturimi u nënshtrohet rregullave të përcaktuara në këtë seksion edhe në rastin kur furnizuesi ka në Republikën e Shqipërisë selinë e aktivitetit të tij ekonomik ose një vendndodhje të qëndrueshme nga e cila është kryer furnizimi ose, në mungesë të një selie ose një vendndodhjeje të qëndrueshme, furnizuesi ka në Republikën e Shqipërisë adresën e tij të përhershme ose zakonisht banon, pavarësisht se furnizimi i mallrave ose shërbimeve, ashtu siç parashikohet në kreun IV, të këtij ligji, konsiderohet të mos jetë bërë në Republikën e Shqipërisë.

3.Në rastin kur faturimi kryhet nga personi i tatueshëm që ka marrë furnizimin, nëpërmjet vetëfaturimit, fatura lëshohet siç përcaktohet në pikën 1, të këtij neni.

Neni 97
Lëshimi i faturave

1. Personi i tatueshëm duhet të sigurohet për lëshimin e faturës nga ai vetë ose nga blerësi i tij ose në emrin e tij dhe për llogari të tij nga të tretët, në rastet e mëposhtme:

a)për çdo furnizim malli ose shërbimi që kryen kundrejt një personi tjetër të tatueshëm ose një personi juridik të patatueshëm;

b)për çdo pagesë të kryer para se të kryhet furnizimi i mallit ose para përfundimit të furnizimit të shërbimit, sipas shkronjës "a", të kësaj pike.

2. Ndryshe nga sa parashikohet në pikën 1, të këtij neni, lëshimi i faturës nuk kërkohet për rastet e furnizimeve të shërbimeve të përjashtuara nga TVSH-ja, sipas shkronjave nga "a" në "e", të nenit 53, të këtij ligji.

Dokumentimi i këtyre transaksioneve bëhet siç përcaktohet nga autoritetet që mbikëqyrin këto lloj veprimtarish, në marrëveshje me autoritetin tatimor dhe duhet të përmbajë, të paktën, informacionin e mëposhtëm:

a) datën e lëshimit;

b) identifikimin e personit të tatueshëm, që furnizon mallrat dhe shërbimet;

c) identifikimin e mallrave dhe të shërbimeve të furnizuara.

(Ndryshuar me Ligj Nr. 85/2019 datë 18.12.2019. Botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 184 datë 31.12.2019)

Neni 98

Të tjera përcaktime mbi faturimin

Përveç sa përcaktohet në nenin 97, personi i tatueshëm duhet të sigurohet për lëshimin e faturës për çdo furnizim tjetër të mallrave ose shërbimeve, pavarësisht vlerës së furnizimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit.

(Ndryshuar me Ligj Nr. 85/2019 datë 18.12.2019. Botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 184 datë 31.12.2019)

Neni 99

Momenti i lëshimit të faturës

1.Fatura lëshohet në momentin e furnizimit të mallit ose shërbimit, përveç rasteve kur përcaktohet ndryshe.

2.Për furnizimet e shërbimeve, për të cilat TVSH-ja paguhet nga marrësi i furnizimit, sipas pikës 2, të nenit 86, të këtij ligji, fatura duhet të lëshohet jo më vonë se data 10 e muajit pasardhës të muajit, gjatë të cilit lind TVSH- ja për furnizimin.

(Ndryshuar me Ligj Nr. 85/2019 datë 18.12.2019. Botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 184 datë 31.12.2019)

3.Personi i tatueshëm, që kryen një furnizim mallrash, detyrohet të lëshojë një faturë për atë furnizim në momentin kur mallrat janë livruar ose kur ato bëhen të disponueshme, në përputhje me dispozitat e parashikuara në seksionin 1, të kreut IV, të këtij ligji.

4.Personi i tatueshëm, që kryen një furnizim shërbimesh, detyrohet të lëshojë një faturë për atë furnizim në momentin kur shërbimet janë kryer.

5.Fatura mund të lëshohet në mënyrë periodike për disa furnizime mallrash ose shërbimesh, të cilat furnizohen në mënyrë të rregullt ose të vazhdueshme, të realizuara midis personit të tatueshëm dhe klientit të tij në të njëjtin muaj, në të cilin furnizimet janë kryer. Në ndërtim fatura tatimore duhet lëshuar çdo muaj.

Neni 100

Raste të tjera të lëshimit të faturës

1.Fatura mund të lëshohet nga blerësi ose klienti i një malli apo shërbimi për furnizimet e mallrave ose shërbimeve të marra prej tij nga një person i tatueshëm nëse ka një marrëveshje paraprake midis dy palëve dhe me kushtin që të ekzistojë një procedurë për pranimin nga furnizuesi i mallit ose shërbimit të çdo fature të lëshuar për llogari dhe në emër të tij.

2.Ministri i Financave përcakton me udhëzim kushtet dhe mundësitë e zbatimit të pikës 1, të këtij neni.

Neni 101
Përmbajtja e faturës

Fatura e lëshuar përpilohet në formën e caktuar nga Ministri i Financave dhe përmban informacionin e mëposhtëm:

a) datën, vendin dhe kohën e lëshimit të faturës.

b) numrin e faturës, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për faturën dhe sistemin për monitorimin e qarkullimit.

(Ndryshuar me Ligj Nr. 85/2019 datë 18.12.2019. Botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 184 datë 31.12.2019)

c)numrin e identifikimit të TVSH-së të personit të tatueshëm që kryen furnizimin e mallrave dhe shërbimeve, sipas përcaktimit të nenit 92, të këtij ligji;

ç) numrin e identifikimit të TVSH-së të blerësit, sipas përcaktimit të nenit 92, të këtij ligji, kur ai është person i tatueshëm për furnizime brenda territorit të Republikës së Shqipërisë;

d) emrin dhe adresën e plotë të shitësit dhe të blerësit; dh) emrin, adresën dhe NIPT-in e transportuesit, targën e mjetit dhe orën e furnizimit;

e)sasinë dhe përshkrimin e mallrave të shitura dhe përshkrimin e shërbimeve të kryera;

ë) datën, në të cilën furnizimi i mallrave ose shërbimeve është kryer ose datën, në të cilën pagesa është kryer, në përputhje me shkronjën "a", të pikës 1, të nenit 97, të këtij ligji, në qoftë se kjo datë është e ndryshme nga data e lëshimit të faturës;

f)kur fatura është lëshuar për pagesë të kryer në avancë dhe TVSH-ja bëhet e kërkueshme në momentin e marrjes së pagesës, si dhe e drejta e zbritjes lind në këtë moment, në faturë duhet të shkruhet "Pagesë në avancë";

g)çmimin për njësi, pa TVSH-në, për çdolloj malli apo shërbimi të furnizuar, si dhe çdo ulje të çmimit ose zbritje që nuk është përfshirë në çmimin për njësi;

gj) vlerën e tatueshme, sipas shkallës tatimore të zbatuar ose të

përjashtuar; h)shkallën e zbatuar të TVSH-së, të shprehur në përqindje;

i)vlerën e TVSH-së së pagueshme, përveç rasteve kur zbatohet një regjim i veçantë, sipas të cilit, në përputhje me këtë ligj, kjo vlerë nuk duhet të tregohet në faturë;

j)vlerën totale me TVSH;

k)kur fatura lëshohet nga blerësi për furnizimin e marrë nga furnizuesi në faturën e lëshuar duhet të shkruhet "Vetëfaturim";

l)në rast se personi i tatueshëm furnizon mallra ose shërbime të përjashtuara nga TVSH-ja, fatura duhet të tregojë dispozitën e këtij ligji, sipas së cilës përjashtohet;

ll)në rast se personi i tatueshëm në cilësinë e blerësit apo klientit është përgjegjës për pagesën e TVSH-së, në faturë duhet të shkruhet "autongarkesë e TVSH-së" (reverse-charge);

m)në rast të zbatimit të regjimit të veçantë për agjencitë e udhëtimit, në faturë duhet të shkruhet "TVSH- ja është zbatuar mbi marzhin, regjimi i agjencive të udhëtimit";

n) në rast të zbatimit të njërit prej regjimeve të veçanta për mallrat e përdorura dhe për objektet e artit, koleksioneve ose antikitetit, në faturë duhet të shkruhet respektivisht "TVSH-ja është zbatuar mbi marzhin, regjimi i mallrave të përdorura"; "TVSH-ja është zbatuar mbi marzhin, objektet e artit"; "TVSH-ja është zbatuar mbi marzhin, objektet e koleksioneve dhe antikitetit";

nj) në rast se personi përgjegjës për pagesën e TVSH-së është një përfaqësues tatimor, për qëllime të nenit 87, të këtij ligji, duhet të tregohet në faturë numri i identifikimit të TVSH-së të përfaqësuesit tatimor, sipas neneve 91 dhe 92, të këtij ligji, së bashku me emrin dhe adresën e tij të plotë.

Fatura, përveç informacionit të përcaktuar në shkronjat "a" deri në "nj", të këtij neni, duhet të përmbajë edhe elemente të tjera, sipas përcaktimit në legjislacionin në fuqi për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit.

Dokumentet e përcaktuara në nënndarjet "i" dhe "ii", të shkronjës "c", të nenit 95, të këtij ligji, përveç informacionit të përcaktuar në nenin 101, duhet të përmbajnë referencat e faturës fillestare përkatëse dhe detajet specifike që ato korrigjojnë.

(Shtuar me Ligj Nr. 85/2019 datë 18.12.2019. Botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 184 datë 31.12.2019)

Neni 102
Dokumente tatimore të thjeshtuara

(Shfuqizuar me Ligj Nr. 85/2019 datë 18.12.2019. Botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 184 datë 31.12.2019)

Neni 103
Kushte të tjera për përmbajtjen e faturave

1.Vlerat e treguara në faturë mund të jenë të shprehura në çfarëdolloj monedhe, me kusht që vlera e tatueshme dhe vlera e TVSH-së për t'u paguar të jetë e shprehur në vlerën ekuivalente në monedhën kombëtare shqiptare (LEK), sipas përcaktimeve të bëra me udhëzim të Ministrit të Financave.

2.Në rastin kur faturat për furnizimet e marra janë të hartuara në gjuhë të huaj, administrata tatimore, për qëllime të kontrollit tatimor, mund të kërkojë përkthimin autentik të faturave në gjuhën shqipe.

SEKSIONI 5
FATURAT LETËR DHE FATURAT ELEKTRONIKE

Neni 104
Mënyra e lëshimit dhe e dërgimit të faturave

Faturat tatimore dhe dokumentet e tjera, të lëshuara sipas këtij ligji, mund të vihen në dispozicion në letër ose në formë elektronike, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit.

(Ndryshuar me Ligj Nr. 85/2019 datë 18.12.2019. Botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 184 datë 31.12.2019)

Neni 105
Kriteret e dërgimit dhe të lëshimit të faturave

Vërtetësia e origjinës, integriteti i përmbajtjes dhe lexueshmëria e një fature, qoftë kjo në letër apo në formë elektronike, duhet të garantohen në përputhje me përcaktimet e legjislacionit në fuqi për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit, duke filluar nga momenti i lëshimit të saj deri në përfundimin e periudhës së ruajtjes së faturës.

(Ndryshuar me Ligj Nr. 85/2019 datë 18.12.2019. Botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 184 datë 31.12.2019)

SEKSIONI 6
DEKLARATA

Neni 106
Deklarata e TVSH-së

1. Çdo person i tatueshëm duhet të dorëzojë një deklaratë TVSH-je, e cila përmban gjithë informacionin e nevojshëm në të cilin bazohet llogaritja e TVSH-në që është bërë e kërkueshme, vlerën e TVSH-së që mund të zbritet, vlerat e tatueshme të veprimeve që lidhen me llogaritjen e TVSH-së së kërkueshme dhe asaj të zbritshme si edhe vlerën e furnizimeve të përjashtuara nga TVSH-ja.

2. Përveç të dhënave që përmban deklarata e TVSH-së, sipas pikës 1, të këtij neni, Ministri i Financave përcakton me udhëzim formën dhe përmbajtjen e plotë të deklaratës si dhe përcakton modalitetet e deklarimit të TVSH-së në lidhje me importet.

~~3.~~ Deklarata e TVSH-së, e bërë sipas pikës 1, të këtij neni, dorëzohet siç përcaktohet në nenin 65, të ligjit për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë, ~~në të cilin parashikohet edhe dërgimi në rrugë elektronike.~~

(Hequr me Ligj Nr. 85/2019 datë 18.12.2019. Botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 184 datë 31.12.2019)

4. Deklarata e TVSH-së, e bërë sipas pikës 1, të këtij neni, do të krijohet automatikisht nga autoriteti tatimor, bazuar në informacionin në librin e blerjes dhe në librin e shitjes. Personi i tatueshëm duhet të kontrollojë të dhënat në atë deklaratë, t'i ndryshojë ose t'i plotësojë ato, nëse është e nevojshme, në përputhje me librin e blerjes dhe të shitjes, të konfirmojë saktësinë dhe plotësinë e tyre, duke përdorur shërbimin elektronik të autoritetit tatimor, dhe ta dorëzojë atë brenda afatit të përcaktuar në nenin 107 të këtij ligji.

(Shtuar me Ligj Nr. 85/2019 datë 18.12.2019. Botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 184 datë 31.12.2019)

Neni 107
Afati i paraqitjes së deklaratës dhe periudha tatimore

1. Deklarata e TVSH-së, e bërë në përputhje me nenin 106, të këtij ligji, duhet të dorëzohet jo më vonë se 14 ditë pas përfundimit të periudhës tatimore që deklarohet.
2. Në kuptim të pikës 1, të këtij neni, periudha tatimore është muaji kalendarik, përveç rasteve kur në këtë nen përcaktohet ndryshe.
3. Për një person të tatueshëm që regjistrohet fillimisht, periudha tatimore fillon në ditën kur certifikata e regjistrimit shënon se regjistrimi hyn në fuqi dhe përfundon në ditën e fundit të atij muaji.
4. Për një person të tatueshëm që çregjistrohet, periudha tatimore fillon në ditën e parë të muajit përkatës dhe përfundon në ditën, në të cilën personi është çregjistruar.
5. Këshilli i Ministrave ka të drejtë të caktojë, me vendim, që për ndonjë kategori personash të tatueshëm, periudha tatimore të jetë më e gjatë se një muaj, por jo më e gjatë se një vit kalendarik.

(Ndryshuar me Ligj nr. 107/2017, datë 30/11/2017. Botuar në Fletoren Zyrtare nr. 222, datë 19.12.2017)

Neni 108
Deklarimi për persona të tjerë

Personat në territorin e Republikës së Shqipërisë, të cilët në mbështetje të neneve 86, pika 2, dhe 87, të këtij ligji, konsiderohen si përgjegjës për pagesën e TVSH-së në vend të personit të tatueshëm, që nuk është i vendosur në territorin e Shqipërisë, duhet të përmbushin detyrimin për të deklaruar, në përputhje me dispozitat e këtij kreu.

Neni 109
Deklarime të tjera

1.Autoriteti tatimor mund t'i kërkojë dhe t'i lejojë personit të tatueshëm të bëjë deklarime të tjera, si shtesë e deklaratave për periudhat tatimore, në përputhje me nenin 67, të ligjit për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë. Në këtë rast deklarimi bëhet në përputhje me pikën 3, të nenit 106, të këtij ligji.

2.Të gjithë personat, të cilët, në zbatim të këtij kreu, kanë detyrimin për të dorëzuar deklaratën e TVSH-së, duhet ta shoqërojnë çdo deklaratë për një periudhë të caktuar tatimore me regjistrat përmbledhës mujorë si për furnizime të kryera, dhe për furnizime të marra dhe saktësime të tyre, të emërtuar përkatësisht libër shitjeje dhe libër blerjeje në përputhje me legjislacionin në fuqi për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit.
(Shtuar me Ligj Nr. 85/2019 datë 18.12.2019. Botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 184 datë 31.12.2019)

. Në këtë rast deklarimi bëhet në përputhje me pikën 3, të nenit 106, të këtij ligji. Këshilli i Ministrave ka të drejtë të caktojë, me vendim, që për ndonjë kategori personash të tatueshëm, regjistrat përmbledhës që shoqërojnë deklaratën e TVSH-së, të jenë për një periudhë më të gjatë se muaji, por jo më e gjatë se një vit kalendarik.

3.Ministri i Financave përcakton me udhëzim formën dhe përmbajtjen e librit të shitjes dhe librit të blerjes.
(Ndryshuar me Ligj nr. 107/2017, datë 30/11/2017. Botuar në Fletoren Zyrtare nr. 222, datë 19.12.2017)

Neni 110
Dispozita të ndryshme

1. Personat e tatueshëm, që i nënshtrohen regjimit të bizneseve të vogla sipas kreut XI, seksioni 1, të këtij ligji, përjashtohen nga detyrimet për faturimin dhe deklarimin e TVSH-së, siç përcaktohet në seksionet 4, 5 dhe 6, të këtij kapitulli.

Këta persona, për faturimin i nënshtrohen dispozitave të legjislacionit në fuqi për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit.
(Ndryshuar me Ligj Nr. 85/2019 datë 18.12.2019. Botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 184 datë 31.12.2019)

2. Prodhuesit bujqësorë, që i nënshtrohen regjimit të kompensimit, siç përcaktohet në seksionin 4, të kreut XI, të këtij ligji, përjashtohen nga përmbushja e detyrimeve mbi faturimin, deklarimin, mbajtjen e kontabilitetit, të përcaktuara në seksionet 4, 5, 6 dhe 7, të këtij kreu.

Neni 111
Dokumentimi i veprimeve të importit

Për veprimet e importimit, lidhur me mallrat që çlirohen për qarkullim të lirë në territorin e Republikës së Shqipërisë, zbatohen formalitetet dhe procedurat e parashikuara në dispozitat doganore në fuqi për importimin e mallrave në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë.

Neni 112
Dokumentimi i veprimeve të eksportit

Për veprimet e eksportimit të mallrave, që çlirohen për qarkullim të lirë drejt territoreve që nuk janë pjesë e territorit doganor të Republikës së Shqipërisë, zbatohen formalitetet dhe procedurat e parashikuara në dispozitat doganore në fuqi për eksportimin e mallrave nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë.

SEKSIONI 7
KONTABILITETI

Neni 113
Përkufizime

Për qëllime të këtij kreu, me termin "ruajtje të një fature në rrugë elektronike" kuptohet ruajtja e të dhënave e kryer me anën e pajisjeve elektronike të trajtimit (përfshirë komprimimin numerik) dhe të memorizimit dhe duke përdorur kabllo, valë, mjete optike apo mjete elektromagnetike.

Neni 114
Detyrimi për të mbajtur regjistrime

1.Çdo person i tatueshëm duhet të mbajë llogaritë e kontabilitetit, të detajuara në masë të mjaftueshme, që TVSH-ja të aplikohet dhe zbatimi i saj të kontrollohet nga ana e administratës tatimore.

2.Çdo person i tatueshëm detyrohet të mbajë llogari, duke përfshirë regjistrat për të gjitha furnizimet e kryera prej tij, të gjitha furnizimet e bëra atij dhe të gjitha importet e mallrave të kryera prej tij, si pjesë e veprimtarisë së tij ekonomike, në përshtatje me ligjin për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare.

3.Çdo person i tatueshëm detyrohet të mbajë regjistrimet sipas këtij neni, ku përfshihen të gjitha faturat dhe çdo dokument tjetër i ngjashëm, të lëshuara nga/ose për personin e tatueshëm, në lidhje me furnizimet e bëra atij dhe të bëra prej tij.

4.Regjistrimet e mbajtura në bazë të këtij neni ruhen për një periudhë prej 5 vjetësh.

5.Ministri i Financave ka të drejtë të përcaktojë formatin e librave ku do të mbahen regjistrimet në lidhje me dokumentet tatimore të parashikuara në këtë ligj, si dhe të parashikojë që regjistrimet e mbajtura sipas këtij neni të regjistrohen në kompjuter ose si të dhëna elektronike.

Neni 115
Ruajtja e dokumenteve tatimore

1. Çdo person i tatueshëm duhet të marrë masa për ruajtjen e faturave të lëshuara nga ai vetë, nga blerësi apo nga marrësi, ose në emër të tij e për llogari të tij nga një i tretë, si edhe të faturave që ka marrë.

2. Personi i tatueshëm ka të drejtë ta caktojë vetë vendin e ruajtjes së faturave apo informacioneve të ruajtura, në përputhje me pikën 1, të këtij neni, me kusht që t'i vërë në dispozicion të autoriteteve kompetente, menjëherë me kërkesën e tyre. Nëse regjistrimet janë mbajtur në kompjuter ose si të dhëna elektronike, t'u lejojë autoriteteve tatimore hyrjen në vendin ku regjistrimet janë mbajtur dhe hyrjen në kompjuter a pajisje të tjera për të inspektuar regjistrimet e mbajtura si të dhëna elektronike.

3.Personi i tatueshëm, i vendosur në territorin e Republikës së Shqipërisë, duhet të ruajë brenda territorit të Republikës së Shqipërisë të gjitha faturat e lëshuara nga ai vetë, nga blerësi

apo nga marrësi, ose në emër të tij e për llogari të tij nga një i tretë, si edhe të gjitha faturat që ai ka marrë, aty ku ruajtja nuk është kryer me anën e një mjeti elektronik që garanton një akses të plotë dhe në linjë te të dhënat në fjalë.

Neni 116
Afati dhe mënyra e ruajtjes së informacionit

1. Periudha, gjatë të cilës personi i tatueshëm duhet të sigurojë ruajtjen e faturave, që lidhen me furnizimet e mallrave apo të shërbimeve, të kryera në territorin e Shqipërisë, si edhe të atyre të marra nga ana e personave të tatueshëm apo jo të tatueshëm, të vendosur në Republikën e Shqipërisë është 5 vite të plota kalendarike, duke filluar nga viti që pason vitin kur lëshohet fatura.

2. Në kuptim të pikës 1, të këtij neni, faturat e lëshuara në përputhje me sa përcaktohet në seksionin 5, të këtij ligji, duhet të ruhen në formën origjinale, në të cilën janë dërguar apo vënë në dispozicion, qoftë kjo letër ose elektronike. Përveç kësaj, në rastin e faturave të ruajtura me mjete elektronike, të dhënat, të cilat garantojnë vërtetësinë e origjinës së faturave dhe integritetin e përmbajtjes së tyre duhet të ruhen gjithashtu me mjete elektronike.

KREU XI
REGJIME TË VEÇANTA

SEKSIONI 1
REGJIMI I BIZNESEVE TË VOGLA

Neni 117
Objekti i regjimit të bizneseve të vogla

1. Personat e tatueshëm rezidentë në Shqipëri, qarkullimi vjetor i të cilëve është nën kufirin minimal të regjistrimit për TVSH-në, janë objekt i regjimit për bizneset e vogla, duke përfituar një përjashtim nga detyrimi për të llogaritur TVSH-në në shitje për furnizimet e mallrave dhe shërbimeve të kryera prej tyre.

2. Kufiri minimal i regjistrimit për TVSH-në, rastet e përjashtimit apo kufiri minimal i regjistrimit për kategori të veçanta, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

3. Nuk përfshihen në regjimin e bizneseve të vogla, në kuptim të pikës 1, të këtij neni, personat e tatueshëm që kryejnë veprimtari ekonomike që përbën evazion fiskal, sipas kuptimit të nenit 116, të ligjit për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë.

(Ndryshuar me Ligj nr. 107/2017, datë 30/11/2017. Botuar në Fletoren Zyrtare nr. 222, datë 19.12.2017)

Neni 118
Veprimtaritë për të cilat nuk aplikohet regjimi

Regjimi nuk aplikohet në rastet e mëposhtme për:

a) furnizimet e kryera në mënyrë rastësore të pasurive të paluajtshme;

b) aktivitetet e përfshira në skemën e prodhuesve bujqësorë;

c) furnizimet e shërbimeve të kryera nga një person i tatueshëm që nuk është i vendosur në Republikën e Shqipërisë, vend në të cilin lind detyrimi për TVSH-në.

Neni 119
Qarkullimi

1. Qarkullimi që shërben për zbatimin e regjimit, sipas nenit 117, të këtij seksioni, përfshin qarkullimin e realizuar nga të gjitha furnizimet e tatueshme të mallrave dhe shërbimeve, përfshirë furnizimet e kryera sipas neneve 57, 59, 60, 61 dhe 62, të këtij ligji, të kryera nga i njëjti person i tatueshëm, dhe llogaritet në bazë të çmimit gjithsej që duhet të paguajë blerësi, pa përfshirë TVSH-në.

2. Nuk merren parasysh për llogaritjen e qarkullimit:

a) furnizimet e aktiveve materiale dhe jomateriale të personit të tatueshëm, që konsiderohen si aktive të investimit dhe nuk mbahen me qëllim për t'u shitur;

b) vlerat e përfituara nga veprimet financiare të parashikuara në nenin 53, shkronjat "b" deri në "e", të këtij ligji, të cilat nuk krijohen si rezultat i kryerjes së veprimtarisë ekonomike, por janë veprime aksesore;

c) vlerat e përfituara nga veprimet mbi pasuri të paluajtshme, të cilat nuk krijohen si rezultat i veprimtarisë ekonomike kryesore, për të cilën personi i tatueshëm është regjistruar.

3. Furnizimet e pasurisë së paluajtshme dhe shërbimet financiare, pavarësisht se janë furnizime të përjashtuara nga TVSH-ja, sipas nenit 53, të këtij ligji, kur krijohen si rezultat i veprimtarisë ekonomike kryesore, bëjnë pjesë në qarkullimin vjetor, për qëllime të pikës 1, të këtij neni.

4. Për qëllime të këtij neni, për një person të tatueshëm, i cili regjistrohet për herë të parë për të kryer një veprimtari ekonomike, qarkullimi në lidhje me kufirin minimal të regjistrimit llogaritet në mënyrë proporcionale me periudhën nga data e krijimit (regjistrimit) deri në fund të vitit fiskal.

Neni 120
E drejta e zgjedhjes

1. Personi i tatueshëm, pavarësisht se plotëson kriteret për aplikimin e këtij regjimi ose e zbaton atë, ka të drejtë të zgjedhë të zbatojë regjimin normal të TVSH-së.

2. Personi që zgjedh të jetë i regjistruar për TVSH-në, sipas pikës 1, të këtij neni, detyrohet të qëndrojë dhe t'i nënshtrohet regjimit normal të TVSH-së jo më pak se 2 vjet kalendarikë.

3. Personi i regjistruar për TVSH-në, sipas këtij neni, ka të drejtë të kërkojë t'i nënshtrohet regjimit të bizneseve të vogla dhe çregjistrimi i tij nga regjimi normal i TVSH-se hyn në fuqi 6 muaj pas datës së paraqitjes së kërkesës.

Neni 121

Faturimi

1. Personat e tatueshëm, që përfitojnë nga përfshirja në këtë regjim, nuk gëzojnë të drejtën e kreditimit të TVSH-së në përputhje me kreun X, të këtij ligji.

2. Këta persona nuk kanë të drejtë të llogaritin TVSH- në në faturë.

3. Nëse personat e tatueshëm që aplikojnë këtë regjim, llogaritin TVSH-në në faturat e tyre, përveçse i nënshtrohen dënimit të përcaktuar në ligjin për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë, duhet të paguajnë TVSH-në e faturuar, ndërsa personi i tatueshëm që ka marrë furnizimin nuk ka të drejtë të zbresë atë TVSH.

Neni 122
Kalimi i kufirit minimal të regjistrimit

1. Personi i tatueshëm, i cili i nënshtrohet regjimit të bizneseve të vogla, qarkullimi i të cilit gjatë 12 muajve të njëpasnjëshëm tejkalon kufirin minimal të regjistrimit për TVSH-në, është i detyruar të kërkojë të regjistrohet brenda 15 ditëve nga data e kalimit të kufirit. Kur kufiri minimal i regjistrimit për TVSH-në tejkalohet më parë se 12 muaj, atëherë personi i tatueshëm duhet të kërkojë të regjistrohet menjëherë brenda 15 ditëve nga data e kalimit të kufirit.

Data e kalimit të kufirit konsiderohet dita e fundit e muajit kalendarik, në të cilin realizohet tejkalimi i kufirit minimal të regjistrimit.

2.Personi i regjistruar për TVSH-në, sipas pikës 1, të këtij neni, ka të drejtë të kërkojë t'i nënshtrohet regjimit të bizneseve të vogla në rast se qarkullimi i tij në 12 muajt e fundit kalendarikë bie nën kufirin minimal të regjistrimit për TVSH-në. Çregjistrimi i tij nga regjimi normal i TVSH-së hyn në fuqi 12 muaj pas datës së paraqitjes së kërkesës për t'iu nënshtruar regjimit të bizneseve të vogla.

SEKSIONI 2
REGJIMI PËR AGJENCITË E UDHËTIMIT

Neni 123
Përkufizime

1.Agjencia e udhëtimit është personi i tatueshëm, i cili vepron si ndërmjetës në emrin e tij dhe kujdeset për të realizuar udhëtimin për klientët.

2.Organizatori i udhëtimeve turistike konsiderohet si agjenci udhëtimi.

3.Termi "Klienti", në kuptim të këtij seksioni, nënkupton udhëtarin ose një agjenci tjetër udhëtimi.

Neni 124
Objekti i regjimit të agjencisë së udhëtimit

1. Veprimet që agjencia kryen në emrin e saj për klientin, për realizimin e të cilave përdor furnizimet e mallrave dhe të shërbimeve të ofruara nga persona të tjerë të tatueshëm, konsiderohen si një shërbim i vetëm i furnizuar nga agjencia e udhëtimit për klientin e saj.

2. Shërbimi i vetëm është i tatueshëm në Republikën e Shqipërisë, nëse agjencia e udhëtimit e ka të vendosur vendin kryesor të aktivitetit të saj ose një njësi fikse, prej së cilës ajo furnizon shërbimin në Republikën e Shqipërisë.

Neni 125
Vlera e tatueshme

1. Vlera e tatueshme e furnizimit të shërbimit të vetëm është marzhi i agjencisë së udhëtimit zvogëluar me vlerën e TVSH-së që lidhet me vetë marzhin.

2. Marzhi i agjencisë së udhëtimit konsiderohet diferenca ndërmjet çmimit total të paguar nga klienti dhe vlerës reale të paguar nga agjencia e udhëtimit për furnizimet e mallrave dhe shërbimeve të faturuara nga persona të tjerë të tatueshëm, për veprimet e kryera në përfitim të drejtpërdrejtë të klientit. Transaksionet, sipas këtij neni, duhet të kryhen nëpërmjet llogarive bankare.

Neni 126
E drejta e zbritjes së TVSH-së

TVSH-ja, që agjencia e udhëtimit u detyrohet personave të tjerë të tatueshëm për veprimet e kryera sipas nenit 124, të këtij ligji, në përfitim të drejtpërdrejtë të klientit të saj, nuk njihet si e zbritshme ose e rimbursueshme.

Neni 127
Raste të tjera

1.Nëse veprimet, për të cilat agjencia e udhëtimit u është drejtuar personave të tjerë të tatueshëm, janë kryer nga këta persona jashtë Republikës së Shqipërisë, shërbimi ikryer nga agjencia e udhëtimit është i ngjashëm me veprimtarinë e ndërmjetësit dhe përjashtohet nga TVSH-ja sipas nenit 62, të këtij ligji.

2.Nëse këto veprime, sipas pikës 1, të këtij neni, janë kryer brenda dhe jashtë Republikës së Shqipërisë, marzhi aplikohet vetëm për shërbimin e agjencisë së udhëtimit të kryer brenda vendit. Pjesa e shërbimit të agjencisë së udhëtimit, që u përket veprimeve jashtë Republikës së Shqipërisë, përjashtohet nga TVSH-ja, sipas nenit 62, të këtij ligji.

Neni 128
Përjashtimet nga regjimi

Përcaktimet e bëra në këtë seksion nuk aplikohen për agjencinë e udhëtimit që vepron vetëm si ndërmjetës në emër dhe për llogari të kryesorit të saj, sipas përcaktimit të shkronjës “c”, të pikës 1, të nenit 40, të këtij ligji.

SEKSIONI 3
REGJIM I VEÇANTË I ZBATUAR PËR SHITJEN E MALLRAVE TË PËRDORURA, VEPRAVE TË ARTIT, OBJEKTEVE TË KOLEKSIONIT DHE ANTIKUARET

NËNSEKSIONI 1
REGJIMI I MARZHIT TË FITIMIT

Neni 129
Përkufizime

Në kuptim të këtij seksioni:

a)"Mallra të përdorura" janë mallrat materiale të luajtshme që janë të përshtatshme për përdorim të mëtejshëm në gjendjen që janë ose pas riparimit, përveç veprave të artit, objekteve të koleksionit dhe antikitetit dhe përveç metaleve të çmuara apo gurëve të çmuar, sipas parashikimeve ligjore.

b)"Vepra arti", "Objekte të koleksionit" dhe "Antikuare" janë ato mallra që përcaktohen në aneksin II bashkëlidhur këtij ligji.

c)"Person i tatueshëm rishitës" është çdo person i tatueshëm, i cili, në kuadër të veprimtarisë së tij ekonomike, me qëllim për të rishitur, blen, përdor për qëllime të aktivitetit të tij ose importon mallra të përdorura, vepra arti, objekte të koleksionit apo antikuare, qoftë për llogari të vetën, qoftë për llogari të të tretëve mbi bazën e një kontrate, për të cilën paguan komision për blerjet ose shitjet.

ç) "Organizator i shitjeve në ankand" është personi i tatueshëm, i cili, në kuadër të veprimtarisë së tij ekonomike, në emër të tij, por për llogari të porositësit, nxjerr mallin e porositësit në ankand për t'ia shitur ofertuesit më të mirë.

d)"Porositësi i shitjes në ankand" është cilido person, malli i të cilit i jepet për t'u shitur organizatorit të shitjes në ankand, mbi bazën e një kontrate, sipas së cilës ai përfiton komision për shitjen.

dh) "Çmim shitjeje" është vlera totale që personi i tatueshëm rishitës ose organizatori i shitjes në ankand përfiton apo do të përfitojë nga blerësi për shitjen e mallrave të përmendura në shkronjat "a" dhe "b", të këtij neni, përfshirë tatimet, taksat, shpenzime doganore, shpenzime dytësore si komisione, shpenzime transporti, ambalazhimi, sigurimi etj., duke përjashtuar shumat e rimbursuara sipas shkronjës "c", të pikës 1, të nenit 40, të këtij ligji.

e)"Çmim blerjeje" është vlera totale e paguar ose për t'u paguar furnizuesit për blerjen e mallrave të përmendura në shkronjat "a" dhe "b", të këtij neni.

Neni 130
Objekti

Regjimi i marzhit aplikohet për furnizimet e kryera nga një person i tatueshëm rishitës i mallrave të përdorura, veprave të artit, objekteve të koleksionit ose antikuarëve, të cilat i janë furnizuar atij brenda territorit të Republikës së Shqipërisë nga personat e mëposhtëm:

a)një person që nuk është i tatueshëm për TVSH-në;

b)një person i tatueshëm, nëse furnizimi i mallrave që ai kryen përjashtohet nga TVSH-ja, sipas nenit 54, të këtij ligji, ose furnizon mallra, për të cilat nuk ka pasur të drejtën e zbritjes së TVSH-së, sipas nenit 74, të këtij ligji;

c)një person tjetër i tatueshem rishitës, në qoftë se funrnizimi i mallrave prej këtij të fundit i është nënshtruar TVSH-së, në përputhje me këtë skemë të marzhit;

ç) një person i tatueshëm, i cili është subjekt i regjimit për bizneset e vogla, sipas përcaktimeve të seksionit 1, të kreut XI, të këtij ligji, dhe furnizimi që kryhet ka të bëjë me mall kapital të përfshirë në aktivet afatgjata.

Neni 131
Vlera e tatueshme

1. Vlera e tatueshme e furnizimit të mallrave, sipas nenit 130, të këtij ligji, është marzhi i realizuar nga subjekti, zvogëluar me vlerën e TVSH-së që lidhet me vetë marzhin.

2. Marzhi i realizuar nga personi i tatueshëm është i barabartë me diferencën ndërmjet çmimit të shitjes së kërkuar nga personi i tatueshëm rishitës dhe çmimit të blerjes.

Neni 132
Marzhi total

1. Për kategori të caktuara të personave të tatueshëm rishitës, vlera e tatueshme për furnizimet e mallrave, për të cilat aplikohet e njëjta tarifë TVSH-je, përbëhet prej marzhit total të realizuar për periudhën për të cilën personi i tatueshëm rishitës detyrohet të paraqesë deklaratë sipas nenit 106, të këtij ligji, zvogëluar me TVSH-në që lidhet me vetë marzhin total.

2. Marzhi total është diferenca ndërmjet vlerës totale të furnizimeve me vlerën totale të blerjeve të mallrave që i nënshtrohen këtij regjimi, të kryera gjatë çdo periudhe, për të cilën personi i tatueshëm rishitës detyrohet të deklarojë.

3. Nëse gjatë një periudhe vlera totale e blerjeve është më e madhe se vlera totale e furnizimeve të kryera, diferenca i shtohet totalit të blerjeve të muajit pasardhës.

4. Personi i tatueshëm rishitës që zbaton këtë regjim bën një rregullim vjetor si më poshtë:

a) nëse diferenca midis vlerës së stokut të datës 31 dhjetor me vlerën e stokut të datës 1 janar të të njëjtit vit është negative, ajo i shtohet blerjeve të kryera në periudhën e parë të vitit pasardhës;

b) nëse diferenca midis vlerës së stokut të datës 31 dhjetor me vlerën e stokut të datës 1 janar të të njëjtit vit është pozitive, ajo i zbritet blerjeve të kryera në periudhën e parë të vitit pasardhës.

5. Kryerja e veprimeve rregulluese mbi vlerën e tatueshme nuk sjell në përfitim të personit të tatueshëm rishitës asnjë të drejtë rimbursimi të tatimit mbi vlerën e shtuar që lidhet me ato transaksione.

Neni 133
E drejta e zgjedhjes

1. Personi i tatueshëm rishitës ka të drejtë të zgjedhë mbi aplikimin e regjimit të marzhit për furnizimet e mallrave të mëposhtme:

a) të objekteve të artit, artikujve të koleksionit dhe antikuarëve, të cilat personi i tatueshëm i ka importuar vetë;

b) të objekteve të artit, të cilat i janë furnizuar personit të tatueshëm nga vetë autori apo nga ata që zotërojnë të drejtat mbi to.

2. Nëse personi i tatueshëm zgjedh të aplikojë regjimin e marzhit për furnizimet e parashikuara në këtë nen, vlera e tatueshme e tyre do të jetë në përputhje me nenin 131, të këtij seksioni.

3. Për furnizimet e objekteve të artit, artikujve të koleksionit dhe antikuareve të importuara nga vetë personi i tatueshëm rishitës, çmimi i blerjes që merret parasysh për llogaritjen e marzhit është i barabartë me vlerën e tatueshme të importit, e përcaktuar në përputhje me nenin 44, të këtij ligji, shtuar me TVSH-në e paguar ose për t'u paguar për importin.

4. Personi i tatueshëm rishitës, i cili ushtron të drejtën, sipas pikës 1, të këtij neni, detyrohet të zbatojë këtë regjim për një periudhë prej të paktën 3 vitesh ushtrimore.

Neni 134
Kufizimi i kreditimit të TVSH-së për regjimin e marzhit

1. Personat e tatueshëm rishitës nuk kanë të drejtë të zbresin TVSH-në në lidhje me blerjet brenda vendit, importimin e veprave të artit, objektet e koleksionit ose të antikuareve kur furnizimi tatohet në përputhje me dispozitat e neneve 129 dhe 130, të këtij ligji.

2. Personi i tatueshëm nuk ka të drejtë të kreditojë TVSH-në për mallrat që i janë furnizuar nga një person i tatueshëm rishitës në qoftë se ky furnizim i është nënshtruar regjimit të marzhit.

Neni 135
Faturimi

Personat e tatueshëm rishitës, të cilët zbatojnë regjimin e marzhit, nuk duhet të llogaritin apo të pasqyrojnë të ndarë vlerën e TVSH-së në faturën e lëshuar. Në çdo faturë të lëshuar që i nënshtrohet regjimit të marzhit, personi i tatueshëm rishitës duhet të shënojë: "Shitje që i nënshtrohet regjimit të marzhit të fitimit".

Neni 136
E drejta për të zbatuar regjimin normal të TVSH-së

1. Për çdo furnizim, për të cilin zbatohet regjimi i marzhit, personi i tatueshëm rishitës mund të zbatojë rregullat për TVSH-në si për çdo person tjetër të tatueshëm. Në këtë rast personi i tatueshëm rishitës gëzon të drejtën e zbritjes së TVSH-së për mallrat e blera me TVSH.

2. E drejta e zbritjes lind në momentin, në të cilin realizohet shitja e mallit, për të cilën personi i tatueshëm rishitës zgjedh opsionin sipas pikës 1, të këtij neni.

Neni 137
Mbajtja e llogarive kontabël

Personat e tatueshëm, të cilët kryejnë transaksione që lidhen me mallrat e përdorura, veprat e artit, objektet e koleksionit apo të antikuareve duhet të mbajnë në mënyrë të ndarë llogaritë për transaksione të kryera me këto mallra, sipas regjimeve të ndryshme që zbatojnë.

NËNSEKSIONI 2
REGJIMI I SHITJEVE ME ANKAND

Neni 138
Objekti

Për shitjet në ankand të mallrave të përdorura, veprave të artit, objekteve të koleksionit apo të antikuareve të kryera nga organizatori i shitjes në ankand, për llogari të porositësit të shitjes në ankand, zbatohet një regjim i veçantë që lidhet me marzhin e realizuar nga organizatori i shitjeve me ankand.

Neni 139
Personat e tatueshëm

Ky regjim zbatohet për furnizimet e kryera nga organizatori i shitjeve me ankand, për llogari të porositësit të shitjes në ankand, i cili është njëri nga personat e mëposhtëm:

a)personi që nuk është person i tatueshëm;

b)personi i tatueshëm, nëse furnizimi i mallrave që ai kryen, mbi bazën e një kontrate komisioni, përjashtohet nga TVSH-ja sipas nenit 54, të këtij ligji, ose furnizon mallra, për të cilat nuk ka pasur të drejtën e zbritjes së TVSH-së, sipas nenit 74, të këtij ligji;

c)personi i tatueshëm, subjekt i regjimit për bizneset e vogla, sipas përcaktimeve të seksionit 1, të kreut XI, të këtij ligji, furnizimi i mallit nga ana e të cilit është kryer mbi bazën e një kontrate komisionere për shitjen dhe ka të bëjë me mall kapital të përfshirë në aktivet afatgjata;

ç) personi i tatueshëm rishitës, nëse furnizimi i mallit nga ana e këtij të fundit, i kryer mbi bazën e një kontrate komisionere për shitjen, i nënshtrohet TVSH-së në përputhje me regjimin e marzhit.

Neni 140
Momenti i furnizimit

Furnizimi i mallrave organizatorit të shitjes me ankand publik konsiderohet si i kryer në momentin kur realizohet shitja me ankand publik e këtyre mallrave.

Neni 141
Vlera e tatueshme

Vlera e tatueshme për furnizimin e mallrave nën këtë regjim përbëhet nga vlera totale që i faturohet blerësit ofertues më të mirë nga ana e organizatorit të shitjes me ankand, zvogëluar me vlerat e mëposhtme:

a)vlera neto që organizatori i shitjes me ankand i ka paguar apo do t'i paguajë porositësit, e cila përbëhet nga diferenca midis çmimit të shitjes në ankand të mallit dhe vlerës së komisionit, që organizatori i shitjes në ankand ka marrë ose do të marrë prej porositësit, mbi bazën e kontratës komisionere për shitjen;

b)vlera e TVSH-së për t'u paguar nga ana e organizatorit të shitjes me ankand për furnizimin e kryer.

Neni 142
Detyrime të faturimit ndaj blerësit

1. Organizatori i shitjes me ankand publik duhet t'i lëshojë blerësit një faturë, në të cilën dallohen veçmas elementet e mëposhtme:

a)çmimi i shitjes me ankand të mallit.

b)tatimet dhe taksat, taksat doganore, tarifat dhe të tjera të ngjashme.

c)shpenzime dytësore, si: komisione, shpenzime transporti, ambalazhimi, sigurimi etj. që organizatori ia ngarkon blerësit të mallit.

2. Në faturën e lëshuar nga organizatori i shitjes me ankand për blerësin nuk duhet të llogaritet apo të pasqyrohet e ndarë vlera e TVSH-së. Në çdo faturë të lëshuar që i nënshtrohet shitjes me ankand organizatori i shitjes në ankand duhet të shënojë: "Shitje që i nënshtrohet regjimit të shitjes me ankand".

Neni 143
Detyrime të organizatorit ndaj porositësit të ankandit

1. Organizatori i shitjes në ankand, të cilit i është dorëzuar malli, mbi bazën e një kontrate komisioni për shitjen me ankand, duhet t'i paraqesë porositësit një pasqyrë të detajuar ku vlera

neto, sipas nenit 141, shkronja "a", të këtij ligji, të detajohet si diferencë midis çmimit të shitjes së mallit në ankand dhe vlerës së komisionit për t'u marrë nga porositësi.

2. Pasqyra e hartuar sipas pikës 1, të këtij neni, zëvendëson faturën që porositësi, në rastin kur është person i tatueshëm, duhet të lëshojë, në momentin e kryerjes së furnizimit në përputhje me nenin 140, të këtij nënseksioni.

Neni 144
Mbajtja e llogarive kontabël

Ministri i Financave mund të përcaktojë me udhëzim dispozita të veçanta lidhur me mënyrën e mbajtjes së llogarive kontabël nga organizatori i shitjes me ankand për transaksionet e kryera në kuadër të shitjes në ankand.

SEKSIONI 4
REGJIMI I VEÇANTË: SKEMA E KOMPENSIMIT TË PRODHUESVE BUJQËSORË

Neni 145
Përkufizime

Për qëllime të këtij seksioni, me termat e mëposhtëm kuptohet:

a)"Prodhues bujqësor" është subjekti që zhvillon aktivitetin e vet në kuadrin e një sipërmarrjeje bujqësore, pyjore dhe peshkimi.

b)"Sipërmarrje bujqësore, pyjore apo peshkimi" është veprimtaria që ushtrohet nga prodhuesit bujqësorë për prodhimin e produkteve bujqësore.

c)"Produkt bujqësor" është një produkt bimor apo shtazor, i cili prodhohet nga një prodhues bujqësor në një sipërmarrje, në kuadrin e aktiviteteve të përcaktuara dhe të listuara, sipas aneksit III bashkëlidhur këtij ligji.

ç) "Kryerja e shërbimeve bujqësore" janë shërbime të kryera nga prodhuesi bujqësor me krahun e vet të punës që disponon dhe me mjetet e punës të sipërmarrjes, së vet bujqësore, pyjore dhe të peshkimit dhe që normalisht kontribuojnë në prodhimin e produktit bujqësor në kuadrin e aktiviteteve prodhuese.

d)"Aktivitetet prodhuese bujqësore" janë ato të përcaktuara sipas aneksit III bashkëlidhur këtij ligji.

dh) "Mallrat dhe shërbimet", në kuptim të këtij seksioni, kuptohen ato produkte dhe shërbime, siç është përcaktuar në shkronjat "c" dhe "ç", të këtij neni.

Neni 146
Objekti i skemës së kompensimit

1.Skema e kompensimit zbatohet për prodhuesit bujqësorë, për të cilët përfshirja në regjimin normal të TVSH-së krijon vështirësi. Këta prodhues, në kuadër të veprimtarisë së tyre prodhuese, të përcaktuar sipas aneksit III, bashkëlidhur ligjit, furnizojnë me produkte dhe

shërbime bujqësore një person të tatueshëm, i cili nuk përfiton nga skema e kompensimit në Republikën e Shqipërisë.

2.Ministri i Financave me udhëzim mund të përjashtojë nga aplikimi i kësaj skeme disa kategori
prodhuesish bujqësorë ose prodhuesit bujqësorë, për të cilët aplikimi i regjimit normal të TVSH-së nuk krijon vështirësi administrative.

3. Çdo prodhues bujqësor, i cili aplikon regjimin e kompensimit të fermerëve, mund të zgjedhë të aplikojë regjimin normal të TVSH-së, me shkallë standarde 20 për qind.

Neni 147
Kushtet për të përfituar nga skema e kompensimit

Prodhuesit bujqësorë përfitojnë të drejtën e kompensimit kur:

a)qarkullimi vjetor i tyre nuk tejkalon kufirin minimal të regjistrimit për TVSH-në, të miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave;

b)furnizojnë mallra apo shërbime me prejardhje nga puna e tyre e kryer në njërën nga aktivitetet e përcaktuara, sipas shkronjës "d", të nenit 145, të këtij ligji;

c)mallrat dhe shërbimet u furnizohen personave të tatueshëm që nuk përfitojnë nga skema e kompensimit në Republikën e Shqipërisë;

ç) janë pajisur me një numër identifikimi të personit të tatueshëm, lëshuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore ku ushtron aktivitetin prodhuesi bujqësor, pa iu nënshtruar detyrimit për deklarim, sipas nenit 106, të këtij ligji.

Neni 148
Norma e kompensimit të prodhuesit bujqësor

Norma e kompensimit të prodhuesve bujqësorë është 6 për qind.
(Ndryshuar me Ligj nr. 96/2018, datë 03.12.2018. Botuar në Fletoren Zyrtare nr.187, datë 28.12.2018)

Neni 149
Vlera e kompensimit

1.Norma e kompensimit aplikohet mbi çmimin pa TVSH të mallrave dhe të shërbimeve, të përcaktuara sipas shkronjës "dh", të nenit 145, të këtij ligji.

2.Kompensimi mbulon TVSH-në e paguar prej prodhuesve bujqësorë, të përfshirë në çmimin e blerjes së mallrave e shërbimeve, që u janë furnizuar atyre për nevoja të kryerjes së aktivitetit prodhues bujqësor.

3.Kompensimi i akorduar i paguhet prodhuesit bujqësor nga blerësi, person i tatueshëm, përkundrejt furnizimeve të kryera të mallrave apo shërbimeve.

Neni 150
Mënyra e zbatimit të skemës

1. Blerësi, person i tatueshëm, lëshon një faturë tatimore për shitësin prodhues bujqësor për çdo furnizim mallrash dhe shërbimesh të marrë prej tij. Vlera e faturës përfaqëson vlerën e furnizimit të paguar nga blerësi për llogari të shitësit, përfshirë normën e kompensimit.

2. Forma dhe përmbajtja e faturës janë përcaktuar në nenin 101, të këtij ligji, në përputhje me natyrën e furnizimit. Në faturë duhet të shënohet NIPT-i sipas nenit 147, shkronja "ç", të këtij seksioni.

3. Kompensimi, që personi i tatueshëm blerës i ka paguar shitësit prodhues bujqësor, është TVSH-ja e zbritshme për personin e tatueshëm, sipas kushteve të neneve 69 dhe 70, të këtij ligji, dhe deklarohet në periudhën tatimore kur është lëshuar fatura.

4. Në qoftë se fatura nuk përmban të dhënat e përcaktuara sipas pikës 2, të këtij neni, personi i tatueshëm nuk ka të drejtë të kreditojë kompensimin e paraqitur në të dhe detyrohet të paguajë dënimin në përputhje me ligjin për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë.

SEKSIONI 5
REGJIMI I VEÇANTË MBI ARIN PËR INVESTIM

Neni 151
Përkufizime

1.Në kuptim të këtij seksioni, me termin "ar për investim" kuptohet:

a) ari në formën e shufrave apo pllakëzave me peshë të pranuar nga tregu i arit më të madhe se 1 gram, me pastërti të barabartë ose më të lartë se 995 të mijtat, i përfaqësuar ose jo me tituj;

b) monedhat prej ari me pastërti të barabartë ose më të lartë se 900 të mijtat, të prera pas vitit 1800, që kanë ose kanë pasur kurs ligjor në vendin e origjinës dhe që, si rregull, shiten me një çmim që nuk e kalon vlerën e tregut të lirë të arit që ato përmbajnë me më shumë se 80 për qind.

2.Për qëllime të këtij seksioni, nuk konsiderohen si të shitura për interesin e tyre numizmatik monedhat e parashikuara në shkronjën "b", të pikës 1, të këtij neni.

Neni 152
Përjashtimi nga tatimi

Përjashtohen nga tatimi mbi vlerën e shtuar:

a)furnizimi dhe importimi i arit për investim, përfshirë arin për investim, të përfaqësuar nga certifikata ari ose të tregtuar në llogaritë e arit dhe, në veçanti, kontratat e shkëmbimit dhe huave të arit, duke përfshirë një të drejtë pronësie ose një pretendim mbi arin për investim, si edhe transaksionet me arin për investim, sipas kontratave "future" dhe "forward", të cilat çojnë drejt transferimit të titullit të pronësisë ose pretendimit mbi atë ar investimi;

b)furnizimet e shërbimeve të kryera nga agjentët, që veprojnë në emër dhe për llogari të një personi tjetër, kur marrin pjesë në furnizimin e arit për investim për porositësin e tyre.

Neni 153
E drejta e zgjedhjes së zbatimit të TVSH-së

1. Personi i tatueshëm, që prodhon ar për investim ose që e shndërron arin në ar për investim, mund të zgjedhë të zbatojë tatimin mbi vlerën e shtuar për furnizimin e arit për investim ndaj një personi tjetër të tatueshëm, që përndryshe do të ishin të përjashtuar mbi bazën e nenit 152, shkronja "a", këtij ligji.

2. Personi i tatueshëm, i cili, në kuadër të veprimtarisë së tij ekonomike, furnizon vazhdimisht me ar që destinohet për përdorime industriale, mund të zgjedhë të zbatojë tatimin mbi vlerën e shtuar për çdo furnizim të kryer sipas shkronjës "a", të pikës 1, të nenit 151, të këtij ligji, ndaj një personi tjetër të tatueshëm, që përndryshe do të ishin të përjashtuara mbi bazën e nenit 152, shkronja "a", të ligjit.

3. Personi i tatueshëm që vepron si agjent në emër dhe për llogari të të tretëve, që kryejnë furnizime të tatueshme sipas pikave 1 dhe 2, të këtij neni, mund të zgjedhë të zbatojë tatimin mbi vlerën e shtuar për furnizimin e shërbimit të kryer.

4. Personi i tatueshëm, i cili vepron sipas pikave 1, 2, 3 të këtij neni, duhet të shënojë në faturën e lëshuar shprehjen: "TVSH-ja është aplikuar në zbatim të nenit 153 të ligjit nr. 92/2014, "Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë"", në të kundërt e drejta e zgjedhjes nuk do të konsiderohet që është ushtruar.

Neni 154
Të drejtat dhe detyrimet e veçanta për operatorët në sektorin e arit për investim

1. Në qoftë se shitja e mëpasshme e arit për investim, e kryer nga personi i tatueshëm, përjashtohet sipas nenit 152, shkronja "a", të këtij ligji, personi i tatueshëm ka të drejtën e zbritjes së shumave të mëposhtme:

a) TVSH-në për t'u paguar ose të paguar për arin për investim, me të cilin është furnizuar prej një personi që ka ushtruar të drejtën e zgjedhjes sipas pikës 1 ose 2, të nenit 153, të ligjit.

b) TVSH-në për t'u paguar ose të paguar, në lidhje me blerjet ose importimin e kryer të arit të ndryshëm nga ari për investim, i cili më pas transformohet nga ai, apo për llogari të tij, në ar për investim;

c) TVSH-në për t'u paguar ose të paguar për shërbimet e marra, që konsistojnë në ndryshimin e formës, të peshës ose të pastërtisë së arit, përfshirë arin për investim.

2. Personat e tatueshëm, që prodhojnë ar për investim ose e transformojnë arin në ar për investim, kanë të drejtën e zbritjes së TVSH-së për t'u paguar ose të paguar prej tyre për blerjet ose importimin e mallrave apo të shërbimeve që lidhen me prodhimin ose transformimin e atij ari, njëlloj sikur shitja e mëpasshme prej tyre e arit të përjashtuar mbi bazën e nenit 152, të ligjit, t'i ishte nënshtruar tatimit.

Neni 155
Mbajtja e llogarive

1. Operatorët, që veprojnë me arin për investim, duhet të mbajnë të paktën kontabilitetin e të gjitha veprimeve thelbësore lidhur me arin për investim dhe të ruajnë dokumentet që mundësojnë identifikimin e klientëve të këtyre veprimeve.
Në kuptim të këtij neni, Ministri i Financave përcakton me udhëzim veprimet të cilat konsiderohen thelbësore.

2. Operatorët i ruajnë të dhënat sipas përcaktimit të bërë në pikën 1, të këtij neni, për një periudhë prej të paktën pesë vjetësh, sipas ligjit për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë.

3. Personat e tatueshëm duhet të regjistrojnë veçmas llogaritë kontabël për transaksionet mbi arin për investim, të përjashtuara sipas nenit 152 nga ato me të drejtë zgjedhjeje sipas nenit 153, të këtij ligji.

KREU XII
DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 156
Dispozita të fundit

Për moszbatimin e dispozitave të këtij ligji apo çdo veprim, mosveprim apo shkelje, që bie në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji, aplikohen sanksionet dhe dënimet sipas përcaktimeve në ligjin për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë.

Neni 157
Dispozita kalimtare

1.Rregullimi i zbritjes së TVSH-së, siç përcaktohet në nenin 80, të këtij ligji, do të aplikohet për mallrat kapitale të luajtshme dhe të paluajtshme, për të cilat e drejta e zbritjes së TVSH-së lind pas datës së hyrjes në fuqi të këtij ligji.

2. (Shfuqizuar me Ligj Nr. 85/2019 datë 18.12.2019. Botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 184 datë 31.12.2019)

3. Në periudhën kalimtare, nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji deri në fillimin e efekteve të dispozitave lidhur me përdorimin e detyrueshëm të faturave elektronike, siç përcaktohet në legjislacionin për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit, personi i tatueshëm, për transaksione pa para në dorë me personin tjetër të tatueshëm dhe personin juridik të patatueshëm duhet:

4. a) të lëshojë fatura tatimore me përmbajtjen dhe në formatin, në përputhje me nenet 101 dhe 104, të ligjit për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë deri në datën e fillimit të efekteve të neneve 11 dhe 13 të këtij ligji;

5. b) të dorëzojë deklaratën e TVSH-së, në përputhje me nenin 106, të ligjit për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë, deri në datën e fillimit të efekteve të nenit 15 të këtij ligji;

6. c) të dorëzojë librin e blerjeve dhe librin e shitjeve, në përputhje me nenin 109, të ligjit për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë, deri në datën e fillimit të efekteve të nenit 16, të këtij ligji.
(Shtuar me Ligj Nr. 85/2019 datë 18.12.2019. Botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 184 datë 31.12.2019)

Neni 158
Autoritetet përgjegjëse

1. Ministria e Financave dhe administrata tatimore kanë përgjegjësinë të administrojnë TVSH-në sipas këtij ligji dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.

2. Administrata doganore ka përgjegjësinë për të vlerësuar, ngarkuar, kërkuar dhe mbledhur TVSH-në në import, eksport dhe në lidhje me regjimet e tjera doganore, sipas këtij ligji.

Neni 159
Nxjerrja e akteve nënligjore

Ngarkohen Këshilli i Ministrave dhe Ministri i Financave për nxjerrjen e akteve nënligjore në zbatim të këtij ligji, jo më vonë se 4 muaj nga data e botimit të këtij ligji në Fletoren Zyrtare.

Ngarkohet Ministri i Financave për nxjerrjen e udhëzimit për zbatimin e seksionit 4, të kreut XI, të këtij ligji, brenda 15 ditëve pas botimit të këtij ligji në Fletoren Zyrtare.

Neni 160
Shfuqizime

1. Me hyrjen në fuqi të këtij ligji shfuqizohen ligji nr.7928, datë 27.4.1995, "Për tatimin mbi vlerën e shtuar", të ndryshuar, të gjitha aktet nënligjore të dala në zbatim të tij, si dhe çdo dispozitë tjetër që bie ndesh me këtë ligj.

2. Përjashtimisht nga pika 1 e këtij neni, nenet 58.1; 58.2; 58.3 dhe 58.4 të ligjit nr. 7928, datë 27.4.1995, "Për tatimin mbi vlerën e shtuar", të ndryshuar shfuqizohen 15 ditë pas botimit të këtij ligji në Fletoren Zyrtare.

Neni 161
Hyrja në fuqi

Ky ligj botohet në Fletoren Zyrtare dhe hyn në fuqi më 1 janar 2015, me përjashtim të sesionit 4, të kreut XI, të këtij ligji, i cili hyn në fuqi 15 ditë pas botimit të këtij ligji në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 24.7.2014

Shpallur me dekretin nr. 8672, datë 11.8.2014 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani

Botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 128, datë 13 gusht 2014.

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare. Miratuar në datën 27.4.2017

Ky ligj botohet në Fletoren Zyrtare dhe hyn në fuqi më 1 janar 2018.

Ky ligj botohet në Fletoren Zyrtare dhe hyn në fuqi më 1 janar 2019

Ky ligj botohet në Fletoren Zyrtare dhe hyn në fuqi më 1 janar 2019

Ky akt normativ hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.
Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare, me përjashtim të neneve 5, 6, 7, 8, 9, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17 dhe 18, të këtij ligji, të cilat i fillojnë efektet respektivisht në të njëjtën kohë me afatet e përcaktuara në legjislacionin për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit.
Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Ndryshuar me Ligj nr. 71/2017, date 27/04/2017. Botuar në Fletoren Zyrtare nr. 113, datë 22.05.2017.
Ndryshuar me Ligj nr. 107/2017, datë 30/11/2017. Botuar në Fletoren Zyrtare nr. 222, datë 19.12.2017
(Ndryshuar me Ligj nr. 40/2018, datë 09.07.2018. Botuar në Fletoren Zyrtare nr. 111, datë 30.07.2018. Hyn në fuqi 01.01.2019)
Ndryshuar me Ligj nr. 96/2018, datë 03.12.2018. Botuar në Fletoren Zyrtare nr.187, datë 28.12.2018
Ndryshuar me Aktin Normativ nr.4, datë 30.11.2019. Botuar në Fletoren Zyrtare nr.161, datë 30.11.201, Miratuar me Ligjin Nr. 78/2019, botuar në Fletoren Zyrtare nr.171, datë 16.12.2019)
Ndryshuar me Ligj Nr. 85/2019 datë 18.12.2019. Botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 184 datë 31.12.2019.
Ndryshuar me Ligj Nr.64/2020, datë 14.05.2020. Botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 118, datë 24.06.2020

ANEKSI I
LISTA E VEPRIMTARIVE TË KRYERA NGA ENTET PUBLIKE

1.Shërbimet e telekomunikacioneve.
2.Furnizimi me ujë, gaz, energji elektrike dhe termike.
3.Transporti i mallrave.
4.Kryerja e shërbimeve portuale dhe aeroportuale.
5.Transporti i personave.
6.Shitjet e mallrave të reja, të prodhuara për shitje.
7.Veprimet e organizmave bujqësorë të ndërhyrjes, lidhur me produkte bujqësore, të kryera në zbatim të rregulloreve mbi organizimin e përbashkët të tregjeve të këtyre produkteve.
8.Menaxhimi i panaireve dhe i ekspozitave me karakter tregtar.
9.Magazinimi.
10.Veprimtaritë e zyrave të publicitetit tregtar.
11.Veprimtaritë e agjencive të udhëtimit.
12.Menaxhimi i shitjeve, i kooperativave, i mensave të ndërmarrjeve dhe të ngjashme.
13.Menaxhimi i enteve radiotelevizive, kur nuk janë të përjashtuara, mbi bazën e nenit 51, shkronja “m”, të këtij ligji.

ANEKSI II
VEPRAT E ARTIT, OBJEKTET E KOLEKSIONIT APO ANTIKUARET

PJESA A
VEPRAT E ARTIT

1. Kuadrot dhe kuadro të ngjashme, piktura e vizatime, të kryera krejtësisht prej dorës së artistit, me përjashtim të planeve të arkitektëve, të inxhinierëve dhe të projekteve dhe skicave të tjera industriale, tregtare, topografike e të ngjashme, të objekteve artizanale të zbukuruara me dorë, të cohërave të pikturuara për skenarë teatri, sfonde studiosh të artit ose për përdorime të ngjashme (kodi NC 9701).

2. Gdhendje, stampime dhe litografi origjinale, saktësisht, ekzemplarët e përftuar në numër të kufizuar drejtpërdrejt në ngjyrë të zezë, ose me ngjyra prej një apo më shumë matricave të punuara krejtësisht me dorë nga artisti, cilado qoftë teknika ose lënda e përdorur, përjashtuar përdorimin e çfarëdolloj metode mekanike ose fotomekanike (kodi NC 97020000).

3. Vepra origjinale të artit të statujave ose të artit të skulpturës, në çfarëdolloj materiali, me kusht që të jenë kryer krejtësisht prej dorës së artistit; derdhja e skulpturave me tirazh të kufizuar, deri në tetë ekzemplarë, e kontrolluar prej artistit, ose atyre që kanë të drejtat (kodi NC 97030000); si përjashtim, në raste të caktuara nga shtetet anëtare, për derdhje skulpturash para datës 1 janar 1989, është e mundur të kalohet kufizimi prej tetë ekzemplarësh.

4. Sixhade muri (kodi NC 58050000) dhe tapete muri (kodi NC 63040000), të kryera me dorë nga vizatimet origjinale të dhëna prej artistëve, me kusht që të mos ekzistojnë më shumë se tetë ekzemplarë.

5. Ekzemplarë unikë qeramike, të kryera krejtësisht me dorë prej artistit dhe të firmosura prej tij.

6. Emalim mbi bakër, të kryer krejtësisht me dorë, brenda kufirit prej tetë ekzemplarësh të numëruara, dhe që mbajnë firmën e artistit ose të studios së tij, me përjashtim të punimeve të filigranës dhe të objekteve të argjendarisë dhe të bizhuterisë.

7. Fotografitë e kryera nga artisti, të shtypura nga ai vetë ose nën kontrollin e tij, të firmosura dhe të numëruara në sasi të kufizuar prej tridhjetë ekzemplarësh, të çfarëdolloj formati dhe kornize.

PJESA B
OBJEKTET E KOLEKSIONIT

1.Pullat postare, markat e pullave, markat postare, zarfet e ditës së parë të lëshimit, kompletet postare dhe të ngjashme, të shlyer apo të pashlyer, por që nuk kanë kurs dhe as nuk destinohen për të pasur kurs qarkullimi (kodi NC 97040000);

2.Koleksione dhe ekzemplarë për koleksione zoologjie, botanike, mineralogjie, anatomie, ose që kanë interes historik, arkeologjik, paleontologjik, etnografik ose numizmatik (kodi NC 97050000).

PJESA C
ANTIKUARET

Mallra të ndryshme nga objektet e artit dhe koleksionet, që kanë një moshë më të madhe se njëqind vjet (kodi NC 97060000).

ANEKSI III
I. LISTA E VEPRIMTARIVE PRODHUESE BUJQËSORE

1. Kultura:

a) bujqësia e përgjithshme, përfshirë vreshtarinë;

b) pemëtaria (përfshirë olivokulturën) dhe hortikultura (perimet, lulet dhe bimët zbukuruese), edhe në serra;

c) prodhimi i kërpudhave dhe i erëzave, i farërave dhe filizave;

ç) mbarështimi i shtretërve të fidanishteve.

2. Blegtoria, në lidhje me kulturën e tokës:

a)mbarështimi i kafshëve;

b)i shpendëve;

c)i lepujve; ç) i bletëve;

d)i krimbit të mëndafshit;

dh) i kërmillit.

3.Pyjet.

4.Peshkimi:

a)peshkimi në ujërat e ëmbla;

b)rritja e peshkut;

c)rritja e midhjeve, rritja e stridheve, rritja e molusqeve dhe e krustaceve; ç) mbarështimi i bretkosave.

II. LISTA TREGUESE E SHËRBIMEVE BUJQËSORE

1.Punimet e kultivimit, vjeljes, shirjes, shtypjes, mbledhjes dhe grumbullimit, përfshirë mbjelljen.

2.Ambalazhimi dhe kondicionimi, si tharja, pastrimi, thyerja, dezinfektimi, futja në silose e produkteve bujqësore.

3.Magazinimi i produkteve bujqësore.

4.Ruajtja, mbarështimi ose rritja e kafshëve.

5.Qiradhënia, për qëllime bujqësore, e mjeteve të përdorura, si rregull në ndërmarrjet bujqësore, pyjore ose të peshkimit.

6.Asistenca teknike.

7.Shkatërrimi i bimëve dhe kafshëve të dëmshme, trajtimi i bimëve dhe tokave me anën e mjegullizimit.

8.Menaxhimi i impianteve të ujitjes dhe të kullimit

9.Prerja e pemëve, e drurëve dhe shërbime të tjera pyjore.